REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "E. ÇABEJ" GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
NJËSIA BAZË E GJUHËS LETËRSISË DHE QYTETËRIMIT GREK

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek"

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Panajot Barka Kryetar, Përgj i NjB
2. Mirela Koça Anëtare
3. Kostando Ksera Anëtare
4. Donika Koçi Anëtare
5. Eleni Agora Anëtare (studente)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**
**R E K T O R I**

*Nr. 1264 Prot.* *Gjirokastër, më 29 / 09 /2023*

**VETËDEKLARIM**

**MBI VËRTETËSINË E DOKUMENTAVE DHE TË DHËNAVE TË TJERA TË DEPOZITUARA NË KUADËR TË VLERËSIMIT TË JASHTËM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT "BACHELOR" NË GJUHË, LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK**

Prof. Dr BEKTASH MEMA

REKTOR, UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

Nën përgjegjësinë time, si titullar i Universitetit "EQREM ÇABEJ", deklaroj si vijon:

1. Të dhënat e paraqitura në raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në dosjen e vetëvlerësimit (DVV) të programit të studimit "Bachelor" në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek që depozitohen në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), janë të vërteta, të sakta dhe produkt origjinal i Universiteti "Eqrem Çabej".

2. Dokumentat mbështetëse të dorëzuara në ASCAL si pjesë e DVV në kuadër të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit "Bachelor" në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, janë produkt i institucionit dhe kopje identike me ato origjinale që gjenden pranë Universitetit "Eqrem Çabej".

3. Të dhënat e paraqitura e deklaruara në dosjen e vetëvlerësimit janë në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

**REKTOR**

**Prof. Dr. Bektash MEMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

**Vlerësimi i Njësisë Kryesore**
**Dekani i FESHSH**
**Prof. Dr. Gëzim Sala**

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË VETVLERËSIMIT (RVB)

### TABELA E SHKURTESAVE NË RVB

### 1. HYRJE PËR PROCESIN E VETËVLERËSIMIT (VLERËSIM I BRENDSHËM (RVB)

- Parimet e GVB-së në hartimin E RVB-së
- RVB-ja struktura dhe objektivat
- Etapat që ndoqi GVB-ja për hartimin e RVB-së.
- Përmbledhje e të dhënave për programin në proces të VB
- Përshkrimi i procesit të vlerësimit të brendshëm

### 2. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË GJUHË, LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK

**Standartet**

- ✓ Ofrimi i programit të studimeve
- ✓ Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit të ciklit të parë bachelor
- ✓ Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat
- ✓ Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit
- ✓ Studentët dhe mbështetja e tyre
- ✓ Sigurimi i cilësisë së programit të studimit bachelor

### 3. PËRMBYLLËSE

- ➢ Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor "në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"

- ➢ Pikat e forta dhe afirmime
- ➢ Pika të dobta.

- ➢ Tabela përfundimtare për shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

- ➢ Tabelat me emërtesat e evidencave për çdo standart

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## TABELA E SHKURTESAVE

| Nr | Emërtesa e plotë | shkurtesa |
|---|---|---|
| 1 | Ministria e Arsimit dhe Sportit | MSA |
| 2 | Ligji për Arsimin e Lartë | LAL |
| 3 | Vendim i Këshillit të Ministrave | VKM |
| 4 | Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë | ASCAL |
| 5 | Qëndra e Shërbimeve Arsimore | QSHA |
| 6 | Institucion i Arsimit të Lartë | IAL |
| 7 | Universiteti "E. Çabej" Gjirokastër | UGJ |
| 8 | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore | FESHSH |
| 9 | Fakulteti i Shkencave të Natyrës | FSHN |
| 10 | Fakulteti Ekonomik | FEk |
| 11 | Njësia Bazë | NJB |
| 12 | Njësia Bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek | NJBGJLQGR |
| 13 | Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek | DBGJLQGR |
| 14 | Senati Akademik i UGJ-së | SA |
| 15 | Life Long Learning | LLL |
| 16 | Korniza Shqiptare e Kualifikimit | KSHK |
| 17 | Bordi i Administrimit i UGJ-së | BAUGJ |
| 18 | Statuti i UGJ-së | SUGJ |
| 19 | Rregullore e UGJ-së | RRUGJ |
| 20 | Rregullore e studimeve në UGJ-së | RRSUGJ |
| 21 | Sistemi Evropian i Transferimit dhe Grumbullimit të Crediteve | ECTS |
| 22 | Qëndra Universitare Ndërdisiplinore e Kërkimi Zhvillimit UGJ, | QUNKZH-UGJ |
| 23 | Rregullore e Brendshme e NJBGJLQGR | RRB NJBGJLQGR |
| 24 | Rregullore e Programit të Studimit të NJBGJLQGR | RRPS NJBGJLQGR |
| 25 | Rregulore e Njësisë Kryesore FESHSH | RRFESHSH |
| 26 | Strategjia e Zhvillimit të UGJ-së 2020-2025 | SZHUGJ |
| 27 | Strategjia e Zhvillimit të FESHSH | SZHFESHSH |
| 28 | Strategjia e Zhvillimit të NJBGJLQGR | SZH NJBGJLQGR |
| 29 | Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave | SSCK |
| 30 | Kodi i Etikës | KEt |
| 31 | Sigurim i Brendshëm i Cilësisë | SBC |
| 32 | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë | NJSBC |
| 33 | Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative | DSHNA |
| 34 | Grupi i Vlerësimit të Brenshëm | BVB |
| 35 | Grupi i Vlerësimi të Jashtëm | GVJ |
| 36 | Raport i Vlerësimit të Brendshëm | RVB |
| 37 | Raport i vlerësimit të Jashtëm | RVJ |
| 38 | Personel Akademik Efektiv | PAE |
| 39 | Personel Akademik me Kohë të Pjesshëm | PAK |
| 40 | Bachelor | BSC |
| 41 | Program Studimi i Nivelit të Parë | PSNP |
| 42 | Rregullore e Punësimit të Personelit Akademik Administrativ në UGJ | RRPPAA-UGJ |
| 43 | Agjensia e Prokurimeve Publike | APP |
| 44 | Buletini i Prokurimeve Publike | BPP |
| 45 | Rregullore e Sekretarisë Mësimore | RRSM |
| 46 | Rrjeti Akademik Shqiptar | RASH |
| 47 | Sektori i Shërbimeve Juridike | SSHJ |
| 48 | Sektori i Marrëdhënjeve me Jasht | SMJ |
| 49 | Minoritet Etnik Grek | MEG |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**HYRJE**

## PËR PROCESIN E VETËVLERËSIMIT (VLERËSIM I BRENSHËM-RVB)

Raporti i Vlerësimit të Brenshëm, (RVB) për programin e studimit, Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, të Njësisë Bazë me të njëjtën emërtesë (NJBGJULQGR) është hartuar nga një grup anëtarësh të stafit akademik të NJBGJLQGR dhe studentë dhe përbën hapin kryesor në procesin e akreditimit të këtij programi nga ASCAL. Grupi i punës është përcaktuar si Grupi i Vlerësimit të Brendshëm , GVB. Procedurat për ngritjen e GVB-së filluan në UGJ, pas urdhërit të Rektorit të UGj-së nr.348 prot, datë 17.03.2023. Në zbatim të tij ,Njësia Bazë, me vendim nr 7, datë 04.04.2023 propozoi ngritjen e GVB për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek i cili u aprovua nga Dekani Rektori dhe është institucionalizuar nga Senati Akademik me vendim nr. 26. Datë28.09.2023

### PARIMET E GVB-së NË HARTIMIN E RVB-së

- Vlerësimi i programit të arrihet në bazë të standarteve dhe parimeve të ASCAL të karakterizohet nga metodologjia e saktë, profesionalizmi, objektiviteti, gjithëpërfshirja, argumentimi dhe transparenca.
- Objekti i vlerësimit të programit të studimit është gjithëplanesh dhe përfshin veprimtarinë e NJBGJULQGR në administrimin e programit të studimit, Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, FESHSH dhe UGJ-në.
- Vlerësimi të përcaktojë qartësisht raportet kontribuese në realizimin e programit të studimit në akreditim midis NJBGJLQGR, FESHSH dhe UGJ.
- Për arritjen e qëllimit të bashkëpunojë me faktorë brenda NJB, UGJ-së dhe jashtë tyre. Kërkon, administron dhe menaxhon në funksion të RVB-së burimet dhe informacionet e duhura dhe që i vihen në dispozicion.
- Produkti i GVB-së është Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për vitet akademike 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023.

### RVB-ja STRUKTURA DHE OBJEKTIVAT

RVB-ja u krye duke operuar me kërkesat e 6 standarteve (fushave) të përcaktuara nga ASCAL.

- Ofrimi i programit të studimeve .
- Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit të ciklit të parë bachelor
- Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat.
- Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit
- Studentët dhe mbështetja e tyre
- Sigurimi i cilësisë së programit të studimit bachelor

Çdo fushë analizon kërkesat e kritereve, duke përfshirë pjesën përshkrimore dhe duke dhënë tregues të matshëm, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit.

Çdo argument shoqërohet nga dokumentacion zyrtar në rang UGJ-je, FESHSH dhe NJBGJULQGR dhe të kornizës ligjore përkatëse në tërësi.

Bazuar në këtë analizë RVB përcakton vlerësimet përfundimtare të përmbushjes së standardeve të çdo fushe, dhe të fushave në tërësi.

RVB synon krijimin e një imazhi të qartë, transparent të këtij programi, të tillë që të mund të shërbejë si bazë për ndërtimin e politikave të zhvillimit të tij, në përputhje me misionin e NJBGJULQGR dhe të kryerjes së procesit të metejshëm të akreditimit.

Të bëjë publik një informacion të plotë dhe transparent për palët e interesuara dhe partnere për asetet e ofruara nga ky program studimi.

Të shërbëjë për kultivimin e kulturës, për ruajtjen dhe avancimin e cilësisë si element thelbësor dhe të qëndrueshëm për vet misionin e NJBGJULQGR.

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm përmban edhe analizën përfundimtare të institucionit duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.

Kryetari dhe anëtarët e GVB firmosin çdo faqe të RVB që ratifikohet me vulë të njomë të institucionit

## ETAPAT QË NDOQI GVB-ja PËR HARTIMIN E RVB-së.

Arritja e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm u bë e mundur nëpërmjet disa fazave.

1. **Ngritja nga titullari i NJB të GVB-së**. GVB u ngrit me vendimin nr.7., datë 04.04.2023. Mban përgjegjësi zyrtare ndërkohë që kontributi për RVB ishte i të gjithë stafit akademik
2. **Përgatitja e metodologjisë dhe instrumentave**. Kualifikim e GVB-së nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me sektorin kompetent të ASCAL. Këto kontakte u bënë më të specializuara kur anëtarët e GVB morën përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara sipas standarteve dhe kritereve të strukturës së RVB.
3. **Mbledhja e të dhënave.** Mbledhja e të dhënave pati disa karakteristika. Fillimisht u mblodhën të dhënat e përcaktuara nga ASCAL. Pastaj dokumentat ose evidencat që kërkonte hartimi i raportit. Kishte evidenca që lidheshin me UGJ dhe FESHSH dhe evidenca që rezultonin gjatë punës për hartimin e RVB-së, apo dhe nga nevoja që imponpremte faza në vijim.
4. **Analiza, sinteza dhe arritja e konkluzioneve të duhura**
5. **Shkrimi i raportit të VB ose të Vetëvlerësimit dhe kompozimi i tij me redaktime përkatëse**
6. **Komunikimi i rezultatëve të RVB instancave kompetente dhe të interesuara.**
7. **Dorëzimi zyrtarisht i RVB-së pranë ASCAL me kërkesat e realizuara në të gjitha zërat, në kohë optimale dhe në forma print dhe digjitale.**

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i studimit "Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek përbën një vijimësi të programit të studimit themelues të Departamentit, (Vendim nr 435 prot, datë 03.09.1993 të KM). Ka një mision specifik:- përgatitjen e mësuesve për arsimin në gjuhën amtare në Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri (MEG). Më 2006, me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (nr.4440 prot, datë 17.07.2006), ndryshoi emrin, nga "Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Greke" në "Dapartamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek" si edhe përmbajtjen e programit të studimit.

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, u zhvillua në përputhje të plotë me legjislacionin adekuat në Republikën e Shqipërisë dhe atë të UGJ-së. Respekton të gjitha kriteret e udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2017 të MASR dhe të VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018 e ndryshuar. Përbëhet nga 26 lëndë të ndara propocionalisht në tri vite me nga 60 ECTS sipas veprimtarive formuese dhe në përqindjet e përcaktuara. Eshtë në përputhje me nivelin 6 të KSHK

Lëndët e planit mësimor mbulohen nga personeli akademik me kohë të plotë i NJBGJULQGR, nga bashkëpunimi me departamente të tjera në UGJ dhe me universitete homologe greke.

Programi Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek përbën ciklin e parë të studimeve që shërbën si bazë për dy programe të tjera të ciklit të dytë, Master, të specializuara në mësuesi për të gjitha lëndët në gjuhën amtare greke të arsimit bazë parauniversitar në MEG. Si i tillë programi i studimit në proces akreditimi përbën thelbin e programeve të studimit të NJBGJLQGR, e cila në tërësi përbën një veçori universitare në vend dhe në plan ndërkombëtar. Kjo risi së bashku me kontributin real të NJBGJLQGR në UGJ dhe komunitet përbën një aset për Institucionin, i vlerësuar maksimalisht në të dy raportet e akreditimit periodik të tij.

(Vendimi nr. 55, datë 16.12.2021, për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, UGJ, "E. Çabej" Gjirokastër.)

Në jetën e tij 30-vjeçare NJB ka ndryshuar dhe përmiresuar 8 herë programin e studimit dhe planin e tij mësimor.

Zë vend kryesues në UGJ përsa i përket punësimit të të diplomuarve të saj.

Ka një kontribut në ndihmë të arsimit parauniversitar në gjuhën amtare në MEG. Studimi dhe përcaktimi i përspektivave të këtij arsimi, kualifikimi i arsimtarëve dhe përgatitja e teksteve shkollore për shkollat në gjuhën amtare të MEG, përbëjnë akset kryesore të këtij kontributi

NJBGJULQGR shquhet për një veprimtari të spikatur kërkimore-shkencore, kulturore, botuese e shoqërore në funksion të profilit të vet akademik dhe të komunitetit.

Në vitin 2008-2009 aplikoi me sukses programin jo akademik njëvjeçar për mësimin e gjuhës greke dhe njohjes së kultures greke dhe tentoi njëhsimin e programit të vet të studimit me departamente analoge universitare greke.

Zotëron bibliotekën e vet në funksion të programeve të studimit dhe të komunitetit, themeluar më 2003.

Në realizimin e ambicjeve të veta akademike, kërkimore e shkencore, NJBGJULQGR ka patur mbështetje maksimale nga UGJ dhe një bashkëpunim shumëplanesh me Universitete greke . Ky bashkëpunim përbën dhe një asset edhe për UGJ.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

Procesi i akreditimit të Programit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek u krye në zbatim të neneve 14,15,103-106 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr 134, date 21.03.2011, "Për miratimin e standarteve Shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë të IAL-ve", VKM-së nr 824, date 24.12.2021" Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", si edhe duke u bazuar në rekomandimet e Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe në "Udhëzuesin për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në Arsimin e Lartë" publikuar prej saj.

Procesi i akreditimit të Programit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, u zhvillua në kuadrin e këtij procesi në UGJ. Nisi me propozimin e Asamblesë së kësaj Njësie, date 25.11.2022, drejtuar Rektorit të UGJ-së, pasi mori aprovimin e Dekanit të FESHSH, për përfshirjen e këtij programi, në grupin e programeve të studimit që UGJ-ja i kërkonte ASCAL-it për akreditim.

Aplikimi në emër të UGJ-së u krye nga koordninatorja institucionale në systemin AMS me date 14.12.2022 dhe u përcoll zyrtarisht në ASCAL me shkresën nr. 1685 prot date 15.12.2022. ASCAL-i konfirmoi kërkesën e UGJ me shkresën nr.117/1 prot, date 06.03.2023 "Konfirmim i aplikimit për akreditim të 20 programeve të studimit". Njëkohësisht, nëpërmjet sistemim AMS është përcjellë dhe diagrama e periudhës së akreditimit, që nis me vlerësimin e brendshëm.

Pas marrjes së përgjigjës pozitive përfundimtare nga ASCAL, korrik 2023 dhe duke respektuar manualin udhëzues të ASCAL të vitit 2017 "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit" dhe agjenden konkrete, filloi procesi implementues për akreditimin dhe të programit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË**
**BACHELOR NË "GJUHË, LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK"**

# I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti "E.Çabej", Gjirokastër (UGJ), ofron programe studimi në mbështetje të interesave kombëtare. **[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 2, 8]**. Programet e tij të studimit synojnë ruajtjen, konsolidimin dhe transmetimin e vlerave akademike, shkencore, demokratike e kulturore në plan kombëtar dhe ndërkombëtar **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 5].** Ofron të gjitha nivelet e arsimit të lartë të parashikuara në nivelet 5,6,7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Veprimtaria akademike e UGJ-së zhvillohet në përputhje me standartet evropiane të arsimit universitar. Mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit në tërësi të vendit; promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar; stimulon përfitimin e projekteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 8]** Misioni i UGJ-së është t'i përshtatet dhe t'i paraprijë zhvillimit ekonomik e shoqëror të rajonit të jugut dhe vendit, të kthehet në një qëndër të edukimit të vazhdueshëm për rajonin e jugut, të kërkimit shkencor të orientuar nga tregu i punës nga reformat social-ekonomike, nga standartet e reja të integrimit evropian, t'i orientojë këto procese dhe t'u paraprijë. **[Evidenca 1.3, Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, 2020-25, pika 3]**<br>Më konkretisht UGJ-ja ofron programe studimi në përputhje me standardet më koherente akademike dhe profesionale në fushat e mësuesisë, ekonomisë infermjerisë etj. Synon në përgatitjen e profesionistëve në këto fusha, sidomos të mësuesisë dhe të atyre që do të çojnë përpara kërkimin shkencor. **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 11]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, mbështetet në ligjin për arsimin e lartë në fuqi, (ligji 80/2015, Kreu VII, Organizimi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë, nenet, 73,74) dhe aktet e tjera nënligjore (VKM nr 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", ndryshuar me VKM nr.185, datë 25.3.2021, Udhezimin e MASR nr.31,dt..29.12.2017), si edhe në Statutin e UGJ-së **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 63]**<br>Ky program studimi përputhet me misionin dhe strategjinë UGJ-së të shprehura në Statutin e tij, **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 4, 5, 7, 8]**, në Strategjinë e UGJ-së, **[Evidenca 1.3, Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, 2020-2025, Misioni, Vizioni, fq. 8]**; Strategjinë e zhvillimit të Njësisë Kryesore të FESHSH **[Evidenca 1.6, Strategjia e zhvillimit të FESHSH, Misioni, Vizioni dhe prioritetet strategjike, fq 9]**; në strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek **[Evidenca 1. 11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25, Kreu I]**<br>Përveç sa më sipër, programi i studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek ka një veçori dalluese. Ai synon formimin akademik bazë për përgatitjen e mësuesve për të gjitha lëndët në gjuhën amtare greke në shkollat e ciklit fillor dhe AMU të Minoritetit Etnik Grek.<br>Ky program studimi e ka zanafillën tek vendimi Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 03.09.1993 për hapjen e degës gjuhë letërsi greke, me program katërvjeçar me profil në mësuesi në UGJ **[Evidenca 1.29, Vendim për hapjen e Degës Gjuhë Letërsi Greke me profil mësuesië Universitetin e"Eqrem Çabej" në Gjirokastër]**<br>Më 2006 Departamenti/dega, me **vendimin nr. 4440/1 prot dt. 18.07.2006** i **ministrit të Arsimit dhe Shkencës** ndryshoi emër në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" **[Evidenca 1.22, Vendimi i ministrit të Arsimit dhe Shkencës për ndërrimin e emrit të Njësisë Bazë]** |



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | Specifikisht dhe siç u përmend, programi i studimit **Bachelor në Gjuhë, Letërsië dhe Qytetërim Grek** ofron një formim bazë në disiplinat e gjuhësisë, letërsisë dhe lëndëve shoqërore që krijojnë njohuri për kulturën greke.<br>Të diplomuarit në këtë program studimi kanë mundësi punësimi të drejtpërdrejtë. Diploma e tyre plotëson kriterët për vazhdimin e studimeve në programet e studimit të ciklit të dytë të Njësisë Bazë të GJLQGR, (Master në mësuesi) apo në programe të tjera përkatëse integruese, apo dhe në studimet e ciklit të tretë. **[Evidenca 1.9, Rregullore e e brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Neni 2].** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" është hartuar dhe ofrohet në zbatim të përspektivës së zhvillimit të UGJ-së, të përcaktuar në strategjinë e tij. **[Evidenca 1.3, Strategjia e zhvillimit të UGJ-së, 2020-2025, Misioni, Vizioni fq 8, Prioritetet strategjike, pika C; Evidenca 1.25 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UGJ-së]** në strategjinë e Njësisë Kryesore të FESHSH, **[Evidenca 1. 6, Plani i zhvillimit të FESHSH, Misioni, Vizioni dhe prioritetet strategjike fq 9]** të Stratëgjisë së NJBGJLQGR që që administron këtë program studimi, **[Evidenca 1.11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25]**; të Statutit të UGJ-së, **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 62, 63, 65]**; Rregullores së UGJ-së, datë 08.09.2020, **[Evidenca I.2, Rregullore e UGJ-së, Nenet 2, Kreu VI, nenet 42, 43,44, 46, 48, 49]**; Rregullorës së FESHSH , **[Evidenca 1.5. Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Nenet 4 , 5, Kreu IV deri VII, nenet 17 dhe 19- 42]** dhe Rregullorës së Njësisë Bazë, **[Evidenca 1.9, Rregullorja e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, dt. 03.07.2020, nenet: 2, 4, Kreu IV]**<br>Programi është hartuar duke marrë parasysh dhe veçoritë e misionit të vet që lidhen me përgatitjen e mësuesve për të gjitha lëndët shoqërore në gjuhën amtare greke në shkollat e Minoritetit Etnik Grek, si edhe me përgatitjen e profesionistëve të tjerë për nevojat që ka MEG apo dhe me marrëdhëniet midis dy vendeve, Shqipërisë dhe Greqisë, të përcaktuara në Strategjinë e Njësisë Bazë **[Evidenca 1.11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25]**<br>Qëllimi mbetet: të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike; të formojë specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj; të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës; të kontribuojë në zhvillimin arsimor, social dhe kulturor në përgjigje të interesave të Minoritetit Etnik Grek, të Shqipërisë apo dhe të marrëdhënieve të të dy vendeve; të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e kuadrove për një shoqëri të tillë **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", 4, 5, 6; Evidenca 1.3, Strategjia e UGJ-së, 2020-25 pika 3. fq.8; Evidenca 1.11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25].**<br>Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" synon të integrojë studentët në objektivat më të gjera të këtij programi dhe veprimtarisë së NJBGJLQGR të shprehura në fushat e kërkimit shkencor, të promovimit të vlerave kulturore të komunitetit që përfaqëson, t'u ofrojë mundësi për studime të ciklit të dytë dhe të tretë dhe predispozita sa më të mira punësimi. **[Evidenca 1.9, Rregullore e brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsise dhe Qytetërimit Grek, Neni 2].** |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | UGJ-ja është një institucion i arsimit të lartë i kategorisë Universitet, themeluar në 1971 **[Evidenca 1.1.5, Vendimi i hapjes së ILP-së; Evidenca 1.1.4. Vendimi mbi krijimin e Universitetit "Eqrem Çabej"]**. Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit Bachelor në Gjuhë Letersi dhe Qyteterim Grek. Më qartë kjo vërtetohet nga akreditimi periodik i jashtëm i institucionit **(Vendimi nr 55, datë 16.12.2021, për akreditimin periodik të IAL, Universiteti "E. Çabej" Gjirokastër)** |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit | Programi i studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek është program i nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me |

| | |
|---|---|
| duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | misionin e UGJ-së **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Nenet 5, 63; Evidenca 2.12, Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ]**<br>Në përmbajtjen e tij programi respekton me rigorizitet ligjin 80/2015, Kreu VII, nenet, 73,74) dhe aktet e tjera nënligjore si VKM nr 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" të ndryshuar (VKM nr.185, datë 25.3.2021), Udhezimin e MASR nr.31,dt..29.12.2017. Në aspektin e UGJ-së, programi i studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek është kontribues në strategjinë për ndërkombëtarizimin e UGJ-së **[Evidenca 1.25 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UGJ-së; Evidenca 1.13. Lista e projekteve të UGJ-së]**. Pavarësisht veçorive fusha e programit të studimit në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek është në përputhje të plotë dhe me fushën akademike e kërkimore shkencore të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Vërtetohet kjo nga ballafaqimi i misionit të strategjive të FESHSH dhe të NJBGJLQGR, **[Evidenca 1.6, Strategji zhvillimi Njesia Kryesore FESHSH, Vizioni, Misioni, fq 9, Prioritetet strategjike fq.10; Evidenca 1.11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25]**; i aktëve të tjera administruese të programeve të studimit në FESHSH dhe me shumë i veprimtarive të përbashkëta, kërkimore, studimore e promovuese, mobiliteteve, projekteve etj **[Evidenca tabela 20 i anekseve ASCAL]**<br>Fusha specifike e programit të studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek lidhet me krijimin e bazave të nivelit universitar për njohjen, aplikimin, studimin dhe promovimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës greke, si aftësi për punësim të drejtpërdrejtë, por edhe si mundësi për kualifikim të metejshëm në fushën e arsimit në këto disiplina e që lidhen me përgatitjen e mësuesve për lëndët shoqërore në gjuhën amtare greke për shkollat e Minoritetit Etnik Grek apo dhe për shkollat e tjera në këtë profil. **[Evidenca 1.10, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, neni 2; Evidenca 1.11, Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25, neni 2; Evidenca 2.6.1, Model supliment diplome i programit të studimit; Evidencë 2.6, Model diplome i programit të studimit]**<br>Njësia Bazë e Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek bazuar në nenin 86 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin Nr. 31, datë15.11.2022 të MAS , "Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë" ka propozuar kodifikimin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit, Sportit (MAS). Shumë elementë të kodit të programit janë të përbashkëta me programet e tjera të studimit në FESHSH. **[Evidenca 2.7, Përcjellja në MAS të propozimeve për kodifikimin e programeve ; Evidenca 2.14. Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FESHSH-së]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **Po** |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni për hartimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek është vetë Njësia Bazë e GJLQGR, në kuadrin e FESHSH dhe UGJ-së. Anëtarët e asamblesës së NJBGJLQGR, në kuadër të rregullorës së brendshme të saj dhe të rregullores së programit të studimit **[Evidenca 1.9, Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek; Evidenca 1.10, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek]** siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis tyre, duke ndarë ngarkesat mësimore në bazë të profilizimit, kualifikimit dhe aftësive dhe duke marrë detyra dhe përgjegjësi konkrete për administrimin implementues dhe mbarëvajtjen e tij. **[Evidenca 1.8.1 Organograma e NJBGJLQGR; Evidenca Aneks -tabela ASCAL 12.1-3; Evidenca 1.33 Ngarkesa mësimore vjetore e personelit akademik 2022 -2023]**, duke diskutuar për përmirësimin e përmbajtjës lëndore, sylabuset **[Evidenca 3.6. Vendim për aprovimin e syllabusve]**, diskutime për çeshtje të ndryshme **[Evidenca 1.31. procesverbali i mbledhjeve të Njësisë Bazë, disa fletë]**<br>Duke qenë se përmbajtja akademike e programit të studimit realizohet në bashkëpunim me Njësi të tjera Bazë, brenda Njësisë Kryesore, apo dhe me tej në UGJ, vendoset dhe me ta një bashkëpunim institucional dhe akademik duke filluar me njoftimin në kohë të detyrimeve që kanë me Njësinë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek. **[Evidenca 1.32 Njoftim i ngarkesës mësimore të njësive të tjera në NJBGJLQGR]**<br>Ky bashkëpunim shtrihet dhe në fushat e kërkimit shkencor, apo bashkëpunimi me të tretët **[Evidenca 1.13. Lista e projekteve të UGJ-së]**<br>Në aspektin më të gjerë institucional drejtimi, mbikqyrja dhe mbarëvajtja e programit të studimit realizohet nëpërmjet harmonizimit të bashkëpunimit të autoriteve, organeve drejtuese dhe strukturave të tjera të institucionit dhe të përfaqësimit të Njësisë Bazë në to. Këto marrëdhënie rregullohen nëpërmjet akteve normative institucionale:- në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, Statutin dhe rregulloren e UGJ-së, të njësisë kryesore FESHSH dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit. **[Evidenca 1.1, Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Kreu II,III, IV, dhe V; Evidenca 1.2 Rregullore e UGJ-së, Kreu II, III, IV dhe V]** si edhe në dokumenta analoge të Njesisë Bazë **[Evidencat respektive]**.<br>Një faktor i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e realizimit të objektivave të Njësisë së Bazë, efektivitetin e bashkëpunimit përbëjnë analizat e herëpashershme të përmbledhura në raportet vjetore të punës akademike dhe shkencore, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare. **[Evidencat 1.21.2 Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të njësisë bazë të GjLQGr për vitin akademik 2021 – 22; Evidenca 3.9.2. Raport vjetor për veprimtarinë shkencore të njësisë bazë të GjLQGr 2021 – 22]** veprimtari që pasyrohen dhe ne në raportet analoge të njësisë kryesore dhe të UGJ-së. **[Evidenca 1.16. Raportet vjetore të Njësisë kryesore FESHSH, 2021-22; Evidenca 1.19. Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.21. Raporti vjetor UGJ vitiakademik 2021-2022]** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | UGJ ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit **[Evidenca 1.3. Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar fq. 32; Evidenca 1.25 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UGJ-së]**.<br>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi. **[Evidenca 1.12. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ-së; Evidenca 1.13. Lista e projekteve të UGJ-së; Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ-së]**.<br>Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | përfitues janë studentët, personeli akademik dhe institucioni. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. **[Evidencat 1.21.2 Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të NJBGjLQGr për vitin akademik 2021 – 22; Evidenca 3.9.2. Raport vjetor për veprimtarinë shkencore të njësisë bazë të GjLQGr 2021 – 22; Evidenca 1.16. Raportet vjetore të Njësisë kryesore FESHSH, 2021-22; Evidenca 1.19. Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca 1.20 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.21. Raporti vjetor UGJ vitiakademik 2021-2022]**<br>Njësia Bazë e Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, luan një rol me rendësi primare në të gjitha veprimtaritë akademiko-shkencore të UGJ-së me universitete dhe institucione të tjera greke. **[Evidenca.:.. Marrëveshjet e UGJ-së me universitetin e janinës , Maqedonisë Perendimore etj ]** |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Njësia Bazë e Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek bashkëpunimin me të tretë,institucione universitare dhe arsimore parauniversitare, institute kërkimore etj e realizon nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme që UGJ-ja arrin me këta faktorë të tretë. **[Evidenca 3.13 Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarje në aktivitete pedagogjike të DGJLQGr të pedagogëve nga Universitete Greke; Evidenca 3.13.1.Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 17. 11. 2017; Evidenca 3.13.2. Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 22.5.2017; Evidenca 3.13.3.Seminaret trajnuese për mësuesit nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore; Evidenca 3.13.4. Seminarin 6 – mujor për metodat e mësimdhënies; Evidenca 3.13.5 Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore/Greqi 24. 07. 2017]**<br>Një rol me rendësi të veçantë përbën funksionimi i Qëndrës Universitare Ndërdisiplinore e Kërkim Zhvillimit në të cilin Njësia Bazë ka rolin e vet. **[Evidenca 1.23.1 Statuti për Qëndrën Universitare Ndërdisiplinore e Kërkim Zhvillimit]** |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Njësia Bazë e Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, brenda standartit të raporteve vjetore të punës akademike dhe kërkimore shkencore pasqyron në mënyrë analitike bashkëpunimin dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit **[Evidencat 1.21.2 Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të NJBGjLQGr për vitin akademik 2021 – 22; Evidenca 3.9.2 Raport vjetor për veprimtarinë shkencore të njësisë bazë të GjLQGr 2021 – 22]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | po |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | po |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" është një program studimi i ciklit të parë me nevoja për sigurimin e kuadrit arsimor për shkollat në gjuhën amtare të Minoritetit Etnik Grek ku qëllimi i tij kryesor mbetet gjurmimi,kërkimi dhe promovimi i kulturës së këtij minoriteti.. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha greke.<br>Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka kohëzgjatje normale 3(tre) vite akademike dhe një total prej 180 ECTS.<br>**[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 11, pika 1;**<br>**Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek, Neni 1, Neni 4;**<br>**Evidenca 3.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022]**<br>Elementët e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar.<br>**[Evidenca 2.19.2 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.19.3 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca 2.19.1 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]**<br>Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet Diplomë Universitare Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek".<br>**[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 11, pika 4;**<br>**Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek", Neni 4;**<br>**Evidenca 2.6 Model diplome Bachelor në"Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek".** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në lami të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Qëllimi i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" është të ofrojë një formim bazë në fushën e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit grek i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në Gjuhë letërsi Greke apo programe të tjera përkatëse integruese.<br>Nëpërmjet veprimtarive formuese të parashikuara në planin mësimor studentët pajisen me njohuri bashkëkohore në fushën gjuhësore dhe letrare si edhe të kulturës më të gjërë greke të cilat janë të nevojshme për studime në ciklet pasardhëse .<br>**[Evindenca 3.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022;**<br>**ANEKS Tabela Përmbledhëse (Tabela 14) Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek 2022-2023]**<br>Objektivat formuese të këtij programi studimi synojnë:<br>*Së pari*, një formim bazë në disiplinat gjuhësore, letrare dhe metodologjike të cilat do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në Gjuhë, Letërsi dhe qytetërim Grek apo programe të tjera përkatëse integruese.<br>***Së dyti***,është hapja e programeve të përbashkëta të studimit të nivelit të dytë me universitete greke, apo me universitete të tjera të huaja.<br>***Së treti***, aplikimi i programeve të studimit të nivelit të dytë , Master shkencor dhe të tretë , Doktoraturë..<br>***Së katërti*, njohja ndërkombëtare e diplomave në kuadrin e FESHSH.**<br>Konkretisht, ata mund të punojnë si<br>• Punonjës specialist në sektorin publik ose privat të formuar në këndvështrimin gjuhësor, letrar dhe metodologjik duke iu përgjigjur më së miri kërkesave dhe zhvillimeve të sotme në fushën e gjuhësisë , letërsisë, historisë, kulturës etj.<br>• Përkthyes të gjuhës greke.<br>• Me përfundimin e ciklit të dytë Master në Mësuesi, si Mësues të Gjuhës e letërsisë Greke në shkollat e mesme dhe 9-vjecare.<br>Dhe ***së pesti***, ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e Universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.<br>**[Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, Neni 3]** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek", mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar si dhe në Rregulloren e studimeve në UGJ ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite:<br>A. Lëndë bazë (30 kredite – 16.66%);<br>B. Lëndë karakterizuese (84 kredite – 46.66%);<br>C. Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese (35 kredite – 19.44%);<br>D. Lëndë Plotësuese (21 kredite –11.66%);<br>E. Detyrime Përmbyllëse (10 kredite – 5.55%);<br>**[Evidenca 2.19.2 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 2.19.3 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019;**<br>**Evidenca 2.19.1 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021;**<br>**Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 23;** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" në planin mësimor të tij nuk përmban zhvillim të praktikës profesionale.<br>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" përcaktojnë qartë detyrimet përmbyllëse.<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ, **[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 93, pika 1]**, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, **[Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave të Shoqërore, Neni 38, pika 1, pika 2]** dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek", **[Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek, Neni 11, gërma a dhe b]** studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome dhe përfaqësojnë 10 kredite - 5.55% të numrit total të krediteve. |

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca 3.1 Plani mësimor Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)** |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e organizimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" është studime me kohë të plotë. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 8]**<br>Rregullorja e UGJ-së dhe Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në "Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek" përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br>**[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 49, Neni 61, Neni 65; Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 16;**<br>**Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek, Neni 9]**<br>Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kritereve të tjera të vendosura me aktet nënligjore. Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ.<br>**[Evidenca 2.10 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca 2.11.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020; Evidenca 2.11 Lista e studentëve me aftësi të kufizuar; Evidenca 2.9.2 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca 2.9 Vendim Senati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca 2.9.1 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë]** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në:<br>➢ **Rregulloren e studimeve në UGJ**, *Kreu V Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi, nenet 39 – 49,*<br>➢ **Rregulloren e UGJ** *Neni 68, 81, 82, 83*<br>➢ **Rregulloren e njësisë kryesore FESHSH, Neni 34 – 38**, *Mënyrat dhe format e kontrollit të dijeve.*<br>➢ **Rregulloren e brendshme të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek**, *Kreu IV, Neni 18 Kontrolli i Dijeve, Pikat 1.dhe 2,*<br>➢ **Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të parë në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek**, *Kreu V, Vlerësimi i studentit, nenet 27 – 32.*<br>➢ **Rregullore për format e zhvillimit të provimeve në Universitetin "Eqrem Çabej", viti akademik 2020 -2021.**<br>Midis këtyre akteve ekziston kohezion dhe harmoni.<br>Ato u bëhen publike studentëve në fillimin e studimeve në UGJ por edhe në vazhdim deri në përfundimin e tyre. **[Evidenca 5.27 Udhërëfyesi për studentin]** Gjithashtu ato janë të afishuara në faqen e internetit të UGJ http://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/<br>Po ashtu Njësia jonë bazë afishon në faqen e vet të social mediave Web dhe FB, çdo gjë që ka lidhje dhe me veprimtarinë akademike të njësisë bazë.<br>http://www.tmimaelinikon.com/tmima.html,<br>https://www.facebook.com/tmimaellargyr<br>Në bazë të rregulloreve të mësipërme, tezat e provimeve janë të hartuara në mënyrë të tillë që studenti të jetë në dijeni të sasisë së pikëve që përmban çdo pyetje. **[Evidenca 3.4.2. Forma të ndryshme tezash sipas vendimit të S.A; Evidenca 3.4. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve janë të paraqitura në syllabuset e lëndëve përkatëse që çdo anëtar i stafit akademik paraqet në fillimviti pranë Njësisë Bazë dhe marrin miratimin e asamblesë së saj. **[Aneks Tabelat përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset]**<br>Në zbatim të legjislacionit përkatës (Rregullores së UGJ, Rregullores së FESHSH, Rregullores së programit të studimit) në orën e parë të zhvillimit të çdo lënde, pedagogu vë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës përkatëse dhe informon studentët për karakteristikat e saj siç janë: përmbajtja e lëndës, qëllimi i saj, arritjet e pritshme, kohëzgjatja, orët e leksioneve dhe seminareve, detyrimet e studentëve, mënyrën testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, norma e frekuentimit etj.<br>**[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, KREU V** *Kontrolli i dijeve.* **; Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër KREU 7; Evidenca 1.5. Rregullore e njësisë kryesore FESHSH, Neni 34 – 38,** *Mënyrat dhe format e kontrollit të dijeve*; **Evidenca 1.9. Rregullore e brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Neni 18; Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, KREU V,** *Vlerësimi i studentit.*] |
| **Kriteri 3.** Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Në kreun V, (Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi) të Rregullores së studimeve në UGJ, në Rregulloren e FESHSH-së, në Rregulloren e Departamentit dhe të Programit të studimit përcaktohet mënyra e testimit të studentëve dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të tyre. Gjithashtu sipas rregulloreve të mësipërme, në Syllabuset e lëndëve përcaktohen format dhe mënyrat e ndryshme se si realizohet procedura e vlerësimit, të cilat u komunikohen studentëve në orën e parë të zhvillimit të lëndës. **[Evidenca 1.5. Rregullore e njësisë kryesore FESHSH Nenet 34 -38; Evidenca 1.9. Rregullore e brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Neni 18; Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. Kreu V]**<br>Nota përfundimtare e vlerësimit të studentit del si shumatore e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit në provim në normën 20% me 80%. Vlerësimi i vazhduar arrihet në masën 10% nga vlerësimi në testet e ndryshme të zhvilluara dhe 10% nga pjesëmarrja active në seminaret. Në Departamentin tonë në shumicën e lëndëve, në vlerësimin e vazhduar miret parasysh edhe punimi i kryer nga studenti në kuadër të çdo lënde. Vlerësimi në provim është nota ose pikët me të cilat vlerësohet studenti në testin me shkrim që zhvillohet pas mbarimit të lëndës. **[Aneks Tabelat përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset]**<br>**Tezat e provimit** hartohet me pyetje dhe ushtrime të formave të ndryshme, në varësi të profilit të lëndës, me qëllim që studenti të ketë mundësinë të demostrojë njohuritë e tij. Pyetjet formulohen në mënyrë të tillë që kërkojnë përgjigje krijuese dhe gërshetuese të njohurive dhe jo përgjigje mekanike dhe memorizuese të informacionit nga leksioni apo teksti i dhënë. **[Evidenca 3.4. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve; Evidenca 3.4.1. Model i unifikuar i tezes se provimeve; Evidenca 3.4.2. Forma të ndryshme tezash sipas vendimit të S.A.]**<br>Në Rregulloren e FESHSH-së përcaktohet qartë mënyra dhe format e kontrollit të dijeve (Neni 34 e në vazhdim) si dhe e zhvillimit të provimit të kursit, numri i tezave, mënyra e hartimit të tyre, kohëzgjatja e provimit, mënyra e sekretimit, koha e publikimit të rezultateve, etj. |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Njësia bazë, vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Pas mbarimit të çdo simestri bëhet vlerësimi i arritjeve mësimore - akademike e simestrit dhe miren masa për fillimin e simestrit tjetër. Në fund të çdo viti akademik hartohet Raporti vjetor i aktivitetit mësimor – kërkimor të NJB-së. **[Evidenca 3.6.1 Procedurë për miratimin e një syllabusi në NJBGJLQGR; Evidenca Evidenca 3.8. Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të njësisë bazë të GJLQGR 2021 – 22; Evidenca 3.8.1. Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të njësisë bazë** |

| | |
|---|---|
| | **të GJLQGR 2019 – 20; Evidenca 3.8.2. Raport vjetor mbi aktivitetin mësimor – kërkimor të njësisë bazë të GJLQGR 2018 -19]**<br>Njësia përveç diskutimit në Asamble në lidhje me format dhe metodat e mësimdhënies merr edhe vlerësimin e studentëve nëpërmjet pyetësorit për vlerësimin e performancës së stafit akademik. Pyetësori plotësohet nga studentën në përfundim të lëndës përkatëse. **[Evidenca 6.3 Pyetesor i NJB të GJLQGR për vlerësimin e performancës së stafit akademik]** Njëkohësisht diskutimet e vazhdueshme që bëhen me studentët, nga bashkëpunimet për detyrat e kursit ose dhe të punimit përfundimtar të diplomës, personeli mbledh opinionin e studentëve në lidhje me efikasitetin e metodave të mësimdhënies të përdorura, si dhe për propozimet, dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.<br>Matje analoge për mësimdhënien dhe performancën e pedagogëve zhvillon edhe Institucioni .**[Evidenca 6.15 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit; Evidenca 6.12 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor per vitin akademik 2020-2021]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Institucioni interesohet dhe mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Në DGJLQG duke patur si moto kryesore të mësimdhënies sonë tezën "*Mësojmë studentët si të mësojnë*" e konceptojmë mësimdhënien si një ndërveprim që ka në qendër nevojat dhe mundësitë e studentit.<br>Institucioni suporton nëpërmjet:<br>- Krijimit të ambjenteve të përshtatshme ku realizohet programi i studimit.<br>- **[Aneks Tabelat Përmbledhëse:Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)**<br>- Pajisjes së tyre me mjete të teknologjisë bashkëkohore të mësimdhënies **[Evidenca 4.7. Inventari i DGJLQG; Evidenca 4.7.1. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në FESHSH-së]**<br>- Krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit me qëllim përsosjen e metodave të mësimdhënies dhe ngritjen e nivelit akademik. **[Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ-së]**<br>- Bibliotekës qëndrore dhe asaj të NJB-së ku studentët mund të gjejnë bibliografinë e duhur. **[Evidenca 4.8.1. Fondi i librave të bibliotekës së NJBGJLQG; Evidenca 4.8.7 Informacion për bibliotekën e universitetit UGJ]**<br><br>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 mësimdhënia është zhvilluar nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesim nga ana e studentëve dhe personelit akademik në këto platforma nëpermjet mbështetjes nga personeli IT i universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik për përdorimin e këtyre platformave.<br>**[Evidenca 3.2.1. Urdhër për platformën e mësimit online; Evidenca 3.2.2. Implementimi i platformës së mësimit online Classroom; Evidenca 3.2.3. Implementimi i platformës së mësimit online Edumeet; Evidenca 3.2.4 Implementimi i platformës së mësimit online Office 365; Evidenca 3.2.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.2.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca 3.2.7. Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca 3.2.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.9. Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.10. Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.11. Zhvillimi i sezonit te provimeve FESHSH 2020-2021; Eevidenca 3.2.12. Grafiku i konsulltimeve për një javë për periudhën e pandemisë 2021; Evidenca 3.2.13. Informacion në lidhje me platformën që do të aplikojë stafi akademi për zhvillimin e mësimit në distancë ]** |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | NJBGJLQGR inkurajon studentët për të marrë iniciativa dhe për të formatuar ndjenjën e autonomisë e cila bëhet jo vetëm nëpërmjet mësimdhënies, por edhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me studentët, gjatë ndihmesës, udhëzimeve dhe këshillave që u japim vazhdimisht për realizimin e detyrave të ndryshme me të cilat i angazhojmë.<br>Studentët, që ndjekin programin e studimit , një nga detyrat që duhet të shlyejnë për të plotësuar pikët e vlerësimit të vazhduar është përfundimi, dorëzimi dhe prezantimi para grupit i një punimi shkencor individual ose në grup në lidhje me objektin e lëndës që ndjekin, si dhe e detyrave të ndryshme të kursit, për lëndët që parashikohen **[Aneks Tabelat: Tabela nr. 15]**<br>Punimi realizohet me ndihmën e pedagogut. Bashkarisht përcaktojnë temën e punimit dhe në vazhdim pedagogu orienton studentët në lidhje me metodologjinë që do të përdorin si dhe u propozon literaturën e duhur. Komunikimi bëhet në kohën e lirë të pedagogut në bibliotekën e Departamentit por edhe nëpërmjet komunikimit elektronik përmes postës elektronike institucionale të pedagogut dhe studentëve. Prezantimi i punimit parashikohet në syllabuset e lëndëve përkatëse. Orët e fundit të seminareve zakonisht janë në dispozicion të prezantimit të punimeve të studentëve.<br>**[Aneks Tabelat: Tabela 14 Programet lëndore (Syllabuset )]**<br>Gjithashtu pjesëmarja e studentëve në aktivitetet e ndryshme me karakter akademik, shkencor, kulturor, historik, shoqëror, etj, që organizon NJB u jep mundësinë e hapjes së gamës së dijeve dhe horizontit të tyre, i përfshin ata në bashkëbisedime me problematikë më të gjerë, krijojnë lidhje shoqërore si midis tyre edhe me persona të tjerë. **[Evidenca 3.15 Formulari përmbledhës i veprimtarisë të NJB të GJLQGR; Evidenca 3.16 Formulari përmbledhës i veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore të DGJLQGR]**<br>http://www.tmimaelinikon.com/tmima.html,<br>https://www.facebook.com/tmimaellargyr<br>Këto forma dhe metoda të mësimdhënies nxitin në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve, por edhe frymën e bashkëpunimit midis tyre. Ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre si dhe në respektimin e rregullave dhe etikës profesionale. **[Evidenca 3.5. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]**<br>NJB stimulon studentët me rezultate të larta me stimuj financiar. Kjo është një formë për të inkurajuar studentët për arritje më të larta. **[Evidenca 5.32 Foto nga dhenja e bursave nga konsullata]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në zbatim të dispozitave ligjore dhe rregullative që ndiqen në UGJ, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. **[Evidenca 1.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni.39, pika 5; Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 81, pika 1; Evidenca 1.9. Rregullore e brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Neni 18; Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. Kreu V.]** |

| | |
|---|---|
| | Vlerësimi përfundimtar i studentit rezulton si shumë e vlerësimit të vazhduar në masën 20% dhe vlerësimit në provim në masën 80%. **Aneks Tabela Përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset.**<br>Gjatë periudhës kohore të zhvillimit të lëndës studentët vlerësohen në mënyrë të vazhduar nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre aktive në seminare, nëpërmjet testeve të ndryshme të kontrollit të dijeve si dhe nga punimet e ndryshme të përcaktuara në fillim të zhvillimit të lëndës.<br>Ky vlerësin përbën 20% të vlerësimit total dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuar në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. **[Aneks Tabelat: Tabela nr. 15]**<br>Vlerësimi i vazhduar si dhe e drejta e futjes ose jo në provim u komunikohet studentëve nga pedagogu i lëndës, orën e fundit të zhvillimit të saj si dhe afishohet në tabelën e komunikimeve të Departamentit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në institucion nuk aplikohen sisteme elektronike testimi dhe vlerësimi. Përdoren metodat tradicionale të kontrollit të dijeve dhe vlerësimit siç janë: pyetjet dhe përgjigjet, minitestet, detyrat e kursit, projektet, dhe provimi final me shkrim.<br>Gjatë periudhës së pandemisë është përdorur platforma elektronike Microsoft Teams si për mësimdhënie ashtu edhe për kontrollin e dijeve. Personeli akademik i DGjLQG-së ka marrë pjesë në trajnimet e organizuar nga UGJ për hartimin e tezës elektronike të provimit, shfaqjen e rezultateve, planifikimin e orarit të provimit online, etj. nëpërmjet platformës Ms TEAMS për të siguruar mbarëvajtjen e provimit (testimit online) **[Evidenca 3.2.4 Implementimi i platformës së mësimit online Office 365; Evidenca 3.2.5. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.2.6. Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca 3.2.7. Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca 3.2.8. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.9. Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.10. Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.11. Zhvillimi i sezonit te provimeve FESHSH 2020-2021; Aneks. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)]** |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe syllabusin e lëndës përkatëse sipas dispozitave rregullative. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 39; Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90; Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46].**<br>Vlerësimi përfundimtar i studentit rezulton si shumë e vlerësimit të vazhduar në masën 20% dhe vlerësimit në provim në masën 80%. **[Aneks Tabela Përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset; Evidenca 3.4.1. Model i unifikuar i tezes se provimeve]**<br>Shkalla e përvetësimit të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej 10(dhjetë) notash. Nota më e ulët për kalimin në një lëndë është nota 5(pesë). Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë sipas Rregullores së UGJ-së **[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 89]** |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Kontrolli dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale si gjatë procesit të zhvillimit të lëndës dhe vlerësimit të vazhduar, ashtu edhe gjatë vlerësimit përfundimtar, shoqërohet vazhdimisht me komente/feedback dhe këshilla mbi procesin e të nxënit. Qëllimi bazë i mësimdhënies është të ndihmohen studentët në gjetjen e strategjive të ndryshme për përthithjen e njohurive të reja dhe për përftimin e aftësive profesionale. Komentet dhe këshillat ndihmojnë studentin të përmirësohet në të ardhmen.<br>Sipas **Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90** brenda 6 diteve nga data e zhvillimit të provimit rezultatet bëhen publike duke u afishuar në |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | |
|---|---|
| | tabelën e komunikimeve të Departamentit. Studentët vijnë në zyrë, u jepet fletorja e provimit për ta parë dhe diskutojmë rezultatin e provimit duke parë përgjigjet e pyetjeve një nga një dhe duke bërë analizën e rezultatit të arritur dhe duke dhënë sqarimet e duhura. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46]**. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimimi për rezultatin e provimit nga studenti. **[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90].** |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në syllabuset e lëndëve në pikën **Vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës** theksohet: *"Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbeshtetur në ndershmërinë.*<br>*Studentët janë të detyruar :*<br>• *Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim*<br>• *Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër*<br>• *Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat*<br>• *Të respektojnë integritetin dhe dinjitetin njerëzor & professional të personelit akademik dhe atij ndihmës*<br>• *Te respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerezor & professional te studentëve të tjerë.*<br>*Në raste shkeljesh të ketyre rregullave studentët penalizohen sic parashikon Rregullorja e UGJ-së dhe Rregullorja e programit të studimit.*<br>Fryma e përgjithshme që ekziston në Departament është ajo e punimeve origjinale dhe unike për shkak edhe të specifikës së Departamentit tonë. Detyrat e kursit, punimet, projektet e ndryshme me të cilat angazhojmë studentët tanë kanë kryesisht të bëjnë me tema lokale dhe me kërkim në terren, gjë që e bën të pamundur kopjimin ose plagjaturën. Po kështu bashkëpunimi i ngushtë i studentëve me pedagogët mbikqyrja e ngushtë e verpimtarisë së tyre bën që të shmangen fenomenet e plagjaturës dhe kopjimit. **Aneks Tabela Përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset.**<br>**[Evid. 3.5. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25, 26]** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale bazohet ekskluzivisht në parimin e meritokracisë.<br>Duke filluar nga kontrolli i vazhduar i dijeve, i cili zë 20% të vlerësimit përfundimtar, dhe rezulton si shumë e pjesëmarjes aktive të studentit gjatë seminareve, të notave në teste dhe të vlerësimit në punimin shkencor në qoftë se ka. Vlerësimi i vazhduar sekretohet nga vetë pedagogu gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të mësimit, pjesëmarja aktive e studentit në seminare, notat e testeve të ndryshme dhe vlerësimi i punimit. Në përfundim të lëndës përcaktohen pikët e vlerësimit të vazhduar.<br>Në vazhdim tezat e provimit hartohen në bazë të Rregullores së UGJ **[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 83, pikat 1, 2]**, dhe përmbajnë pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse. Gjithashtu tezat e provimeve hartohen në mënyrë të tillë që përgjigjet të jenë krijuese, përgjithësuese dhe vlerësuese të lendës dhe jo thjesht memorizuese që të evitohet kopjimi nga njëra anë dhe nga ana tjetër të stimulohet mendimi kritik, përgjithësues dhe vlerësues i studentit.<br>**[Evidenca 3.4.2. Forma të ndryshme tezash sipas vendimit të S.A; Evid. 3.4.1. Model i unifikuar i tezës së provimeve.]**<br>Zhvillimi i provimit dhe vlerësimi i dijeve, shpallja e rezultateve bëhet në bazë të rregulloreve përkatëse.<br>**[Evidenca 1.2. Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90; Evidenca 1.4. Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej"** |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | **Gjirokastër, Nenet 45, 46; Evidenca 3.5. Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Neni 8, pika 2].**<br>Rezultatet e vlerësimit përfundimtar jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e UGJ. Rezultatet komunikohen deri në 6 (gjashtë) ditë pas zhvillimit të provimit. Ato shpallen në këndin e komunikimeve të Departamentit me qëllim që studentët të njihen me vlerësimin e dijeve të tyre përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare në mënyrë që tu krijohet mundësia e ankimimit. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Deri në 6 (gjashtë) ditë pas shpalljes së rrezultateve përfundimtare, dhe para se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare, studenti ka të drejtë të njihet me fletën e provimit dhe të kërkojë nga pedagogu i lëndës sqarime mbi vlerësimin. Në qoftë se studenti ka paqartësi për vlerësimin ai ka të drejtë të rishikojë personalisht tezën e korrigjuar në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. E gjithë proçedura e rishikimit të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijes parashikohen në **[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90; Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 45, 46; Evidenca 1.5. Rregullores e Njësisë kryesore FESHSH neni 35 pikët 17 dhe 18]** |
| Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Në bazë të Rregullores së Studimeve në UGJ: Neni 46; Rregullores së UGJ: neni 88, Rregullores së FESHSH: neni 35, pikët 17 dhe 18 studenti ka të drejtë të ankohet në rast se janë shkelur:<br>- rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit.<br>- ose për vlerësim të pameritaur.<br>Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit dhe i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit dhe për dijeni Dekanit të Fakultetit. Përgjegjësi vlerëson ankesën sipas parashikimeve të Rregullores, merr vendimin përkatës duke vënë në dijeni edhe Dekanin. (neni 18)<br>Në rastin e vlerësimit të pameritaur ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar Përgjegjësit të Departamentit Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës duke detyruar komisionin të rivlerësojë edhe njëherë testin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. (neni 19) **[Evidenca 1.4. Rregullore e Studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46; Evidenca 1.5. Rregullores e Njësisë kryesore FESHSH neni 35 pikët 17 dhe 18; Evidenca 1.2. Rregullore e brendshëm UGJ, neni 88]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | po |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Në Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 6, **[Evid.1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, neni 6.]** tek Misioni i programit theksohet:<br>6.1. *Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek " ka si **mision dhënien e njohurive bazë** mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një shumëllojshmëri lëndësh mësimore gjuhësore e letrare; rritjen e kompetencës shkencore të studentëve në disiplinat teorike për t'u përgatitur për arsimimin dhe trajnimin e mëtejshëm në fushën e mësuesisë në shkollat në gjuhën amtare të Minoritetit Etnik Grek apo dhe në shkolla të tjera në gjuhën greke në Shqipëri, për njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si edhe për një trajnim e parapërgatitje për* |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| | *kërkim të pavarur në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe qytetërimit grek, shkencave shoqërore, përkthimit, kritikës letrare.*<br>*23.4. Plani mësimor ka karakter ndërdisiplinor me bosht kryesor formimin dhe aftësimin e studenteve me njohuri sa më të plota dhe me aftësi krijuese dhe studimore në fushën e gjuhës dhe letërsisë greke si edhe të kulturës greke në përgjithësi. Neni 23. Faq.8*<br>Programi i studimit në shqyrtim është i hartuar në mënyrë që studenti të pajiset me dije dhe njohuri në 4 fusha ku secila përmban lëndët analoge siç pasqyrohet tek Tabela 4.<br>**LËNDË BAZË** – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (**A**)<br>**LËNDË KARAKTERIZUESE** – përgatitje për disiplinën shkencore (**B**)<br>**LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE** – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C)<br>**LËNDË PLOTËSUESE** – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (**D**)<br>Ndërsa në Tabelën 14 në syllabuset e lëndëve përkatëse, pasqyrohen tematikat që zhvillohen në kuadër të secilës lëndë ku mund të vihet re implementimi i misionit kryesor të programit të studimit dhe qëllimet e tij për dhënien tek studenti të dijeve dhe njohurive të thelluara në këto fusha.<br>**Aneksi Tabela Përmbledhëse (Tabela (9) dhe (Tabela 14) [Evidenca 3.1. Plani mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit ndikon në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve në drejtime të ndryshme duke synuar që ata të marrin njohuritë e duhura për tu përballur me sfidat e shoqërisë.<br>Vetë natyra e Programit të Studimit i cili shtrihet njëkohësisht në fushën e gjuhës, letërsisë, qytetërimit etj. garanton tek studentët zhvillimin e aftësive të veçanta humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit përmes lëndëve që parashikohen të zhvillohen në kuadër të këtij programi. **Aneks Tabelat Përmbledhëse: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)**<br>**[Evidenca 3.1. Plani mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek]**<br>Sipas pikës 6.2 të Rregullores së programit të studimit "*Qëllimi i programit përcaktohet dhe vlerësohet në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve shoqërore të vendit në përgjithësi dhe të sistemit arsimor në veçanti, të nevojave të mëdha që dikton situata aktuale për mësues e specialistë në shkencat shoqërore në përgjithësi dhe për gjuhën, letërsinë greke dhe shkencat shoqërore në gjuhën greke në veçanti, si dhe në kuadër të zhvillimeve të vrullshme të teknologjisë së informacionit, e cila dikton nga ana e saj, objektiva dhe kërkesa të reja në sistemin arsimor të vendit.*"<br>**[Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, neni 6.]**<br>Programi i studimit garanton edhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. Në Planin mësimor në vitin e dytë parashikohet të zhvillohet lënda "Teknologji të reja në komunikim" për të aftësuar studentët në përdorimin e teknologjisë.<br>Gjuha e huaj është e përfshirë në vitin e parë të studimeve dhe jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytëzimin në vijim të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione arsimore jashtë vendit.<br>**Aneks Tabelat Përmbledhëse: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9) dhe (Tabela 14) [Evidenca 3.1. Plani mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek]** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Çdo lëndë e programit të studimit paraqet në syllabuset e vet kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti me zhvillimin e saj. Të gjitha këto së bashku ndikojnë tek studenti në formimin e një personaliteti të kompletuar dhe një specialist të fushës që ka përzgjedhur të studjojë. Synimet dhe qëllimet e lëndës kompetencat dhe aftësitë që do të fitojnë studentët, u bëhen të ditur në fillim të lëndës. **Aneks Tabelat Përmbledhëse: (Tabela 14) Syllabuset**<br>Në fund të lëndës analizohen dhe shqyrtohen masa e arritjes së tyre deri në fazën para provimit përfundimtar.<br>Zakonisht në orët e fundit të zhvillimit të lëndës bëhet një përmbledhje e tematikave që u zhvilluan në kuadër të mësimit. Çështjet themelore që u diskutuan, konceptet bazë |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
Email: info@ascal.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | që u përvetësuan. Gjithashtu kontrollohet masa e kompetencave dhe aftësive të fituara gjatë zhvillimit të lëndës . Kjo procedure zhvillohet pasi nga njëra anë vihen në dukje rezultatet e arritura dhe anët e forta të lëndës si dhe anët e dobëta të saj të cilat do të bëhen shkas për ndryshime si në tematikën e lëndës ashtu edhe të programit të studimit. Qëllim tjetër i kësaj analize është që studentët të bëjnë një përmbledhje dhe një sistemim të lëndës para provës finale, në mënyrë që të fokusohen në çështjet e rëndësishme të lëndës.<br>Një mënyrë e evidentimit të rezultateve janë edhe arritjet e studentëve si gjatë vlerësimit të vazhduar, ashtu edhe atij të provimit përfundimtar në çdo lëndë.<br>**[Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 19, pika 2/b; Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek; Aneksi Tabela Përmbledhëse (Tabela 14) Syllabuset]** |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Në zbatim të ligjislacionit dhe Rregulloreve, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në procesin mësimor dhe ti shndërojnë ato në aftësi profesionale. Kompetencat e fituara në kuadrin e çdo lënde pasqyrohen në syllabusin e lëndës përkatëse. **Aneksi Tabela Përmbledhëse (Tabela 14)**<br>Personeli akademik i DGjLQG-së mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve, detyrave të kursit dhe studimit individual.<br>Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore shkencore.<br>**[Evidenca 4.8.6. Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]**<br>Departamenti GjLQG ka një traditë në organizimin e veprimtarive të ndryshme shkencore dhe kulturore si brenda institucionit ashtu edhe jashtë tij. Studentët janë aktorët kryesorë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve<br>**[Evidenca 3.10. Plani i veprimtarive akademike shkencore dhe kulturore për vitin akademik 2021 -22]**<br>Institucioni nëpërmjet bashkëpunimeve me institucionet bën përpjekje për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve **[Evidenca 1.12. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ-së; Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ-së]** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik realizon leksione si brenda edhe jashtë strukturës së programit të studimit.<br>Njësia bazë GJLQGR karakterizohet për profilin e saj jo të mbyllur<br><br>➢ Aktiviteti i 9 Shkurtit, ditës ndërkombëtare të gjuhës Greke, është përcaktuar si një aktivitet shkencor ku çdo herë pedagogë të departamentit mbajnë leksione dhe kumtesa me tematika të ndryshme në fushën e historisë së gjuhës dhe civilizimit grek. Pjesë e këtij eventi, përveç studentëve dhe stafit akademik, bëhen edhe arsimtarët e MEG si dhe intelektualë të shoqërisë civile.<br>**[https://www.facebook.com/tmimaellargyr Në faqen e Facebook që disponon Njësia bazë mund të ndiqet eventi i Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Greke. Datë 10. 02. 2023]**<br>➢ Është partneri kryesor i organizimit të seminareve kualifikuese të mësuesve për shkollat e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri. **[Evidenca 3.13.1.Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës. 17. 11. 2017; Evidenca 3.13.2. Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 22.5.2017; Evidenca 3.13.3. Seminaret trajnuese për mësuesit nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore]** |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ➢ Fton profesorë nga Universitet partnere të Greqisë për leksione të hapura si në kuadër të mobiliteteve edhe në kuadër të aktiviteteve të ndryshme që organizon. **[Evidenca 3.13. Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarje në aktivitete pedagogjike të DGJLQGr të pedagogëve nga Universitete Greke.]** **https://www.facebook.com/tmimaellargyr 11 Μαΐου 2023]**<br>➢ Veprimtari si ajo e ditës së 200 vjetorit të poezisë moderne greke në kuadër të javës së kulturës Greke. [**https://www.facebook.com/tmimaellargyr 27 Μαΐου 2022**<br>➢ Anëtarët e stafit akademik marrin pjesë me referime dhe kumtesa në aktivitete të ndryshme që organizon komuniteti (Simpoziume shkencore, prezantime etj.<br>**[Evidenca 3.10. Plani i veprimtarive akademike shkencore dhe kulturore për vitin akademik 2021 -22; Evidenca 3.15 Formulari përmbledhës i veprimtarisë të NJB të GJLQGR; Evidenca 3.16 Formulari përmbledhës i veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore e DGJLQGR]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | po |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Institucioni nuk ka një rregullore të posaçme për provimin e përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës, por ai e ka të përcaktuar qartë këtë procedurë në Kreun VIII "*Diplomimi*", i **Rregullores së Studimeve në UGJ**, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64 **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**, në Nenin 93 të **Rregullores së UGJ [Evidenca 1.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**, Kreun VII "*Diplomimi*", në Nenet 39-42 të Rregullores së FESHSH-së **[Evidenca 1.5 Rregullore e FESHSH]** dhe në nenin 26 në **Rregulloren e programit të studimit Bachelor në GjLQG.**<br>Pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome parashikohet në Rregulloren e FESHSH Kreu VII, neni 39 dhe në Rregulloren e Programit të studimit, Neni 26 dhe është 8 (tetë). Pjesa tjetër e studentëve që nuk e arrin këtë prag, testohen me provimin e përgjithshëm përfundimtar.<br>**Në Rregulloren e Programit të studimit, Neni 26** "*Mbrojtje të diplomës me punim teze*" theksohet:<br>*26.1. Mbrojtja e diplomës bëhet me provim formimi. Mund të bëhet dhe me punim teze në rastet kur:*<br>*a. Studenti në dy vitet e para të studimit ka arritur një notë mesatare mbi 8 (tetë) (në përgjithësi ose në një fushë që ai do të aplikojë)*<br>*b. Studenti duhet të jetë dakord dhe të paraqesë kërkesë pranë përgjegjësit të Departamenit. Kërkesa paraqitet jo më vonë së katër javë mësimore nga fillimi i vitit të tretë.*<br>**[Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek.]**<br>Ky nen u komunikohet studentëve me fillimin e programit të studimit, momentin e njohjes së tyre me Rregulloren e programit, strukturën e studimeve, planin mësimor dhe legjislacionin përkatës.<br>Po kështu Rregulloret janë të afishuara në web –site –in e UGJ në linkun http://uogj.edu.al/# |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion | Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik i NJBGJLQG në fillim të vitit të fundit të studimeve asistojnë studentët, duke u vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose |

| | |
|---|---|
| informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | mbrojtjes së diplomës, në respektim të Rregullores se studimeve në UGJ [**Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61**] dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje [**Evidenca 3.7.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve.**] si dhe të Rregullores së programit të studimit [**Evidenca 1.10.Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek.**]<br>Përgjegjësi dhe personeli akademik i Njësisë Bazë informojnë studentët në lidhje me kushtet dhe rregullat e mbrojtjes së diplomës me punim teme ose me provim final.<br><br>➢ Hartojnë listën e temave që u propozohen studentëve për punim diplome në fillim të semestrit të pestë (Kjo listë në vazhdim modifikohet sipas interesave të studentëve. Ata mund të vendosin vetë temën ose të përzgjedhin nga lista e temave të dhëna.)<br>➢ Hartojnë programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar i cili është gjithëpërfshirës i njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike. [**Evidenca 3.7. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar**]<br>➢ Vënë në dispozicion të studentëve që do të kryejnë punim teme manualin e punimit të diplomës. [**Evidenca 3.7.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve.**]<br>➢ Përcaktojnë personelin akademik që do të jetë udhëheqës për secilin nga studentët që, sipas rregullores, dëshiron të kryejë punim diplome.<br>➢ Asiston studentin në evidentimin e detyrimeve për procesin e diplomimit [**Evidenca 3.7.1. Urdhër për kondrollin e dokumentacionit për procesin e diplomimit**]<br><br>Udhëheqësi mbikqyr dhe asiston studentin që nga fillimi deri në përmbyllje të procesit të mbrojtjes së diplomës me punim teme. Fillimisht diskutojnë për të formuluar bashkarisht temën e punimit si dhe strukturën e saj, në vazhdim udhëheqësi i propozon literaturën e duhur dhe metodologjinë e punës. Studenti paraqet punimin e diplomës pasi ka marë miratimin e udhëheqësit. Sipas nenit 61 të Rregullores së studimeve në UGJ dhe Nenit 39 të Rregullores së FESHSH-së |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personeli akademik i departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit 3 ose 5 i propozon përgjegjësi i Njësisë Bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. [**Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 3, 2. Neni 64**]<br>Personeli akademik i NjBGJLQG-së harton programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar i cili është gjithëpërfshirës i njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit.duke përfshirë në të, të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Programi miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit.<br>[**Evidenca 3.7. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar**]<br>Po kështu hartohen edhe tezat e provimit përfundimtar. Ato hartohen në mënyrë të tillë që të përmbajnë pyetje nga të gjitha fushat e studimit. [**Evidenca 3.4.3 Tezë e provimit përfundimtar**] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Sipas nenit 61 të Rregullores së studimeve në UGJ , **Në bazë të Rregullores së Programit të studimit, Neni 26** *Mbrojtje të diplomës me punim teze*<br>*c. Udhëheqësi propozohet nga studenti, ose nga vet personeli akademik dhe aprovohet nga Asambleja e Departamentit, jo më vonë se një javë nga paraqitja e kërkesës.*<br>*d. Studenti dhe udhëheqësi caktojnë temën dhe strukturën e punimit të tezës dhe ia paraqesin përgjegjësit të departamentit jo më vonë se një javë nga data e marrjes së vendimit.*<br>Udhëheqësi mbikqyr dhe asiston studentin që nga fillimi deri në përmbyllje të procesit të mbrojtjes së diplomës me punim teme duke i propozuar literaturën e duhur dhe metodologjinë e punës. Studenti paraqet punimin e diplomës pasi ka marë miratimin e udhëheqësit. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

EA

| | |
|---|---|
| | Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëlidhur Rregullores se studimeve në UGJ faq.39. **[Evidenca 3.7.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve.]** |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Njësia bazë GJLQGR disponon mjedis të përshtatshëm i cili u ofron studentëve mundësitë për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit.<br>Biblioteka e Departamentit është e pajisur me një numër të madh librash në lidhje me fushat e programit të studimit të cilat studentët mund ti shfytëzojnë si në ambjentet e bibliotekës por edhe mund t'i huazojnë. Gjithashtu në ambientin e bibliotekës gjendet edhe një kompjuter me akses në internet i cili mund të përdoret nga studentët.<br>Sipas nenit 38, të Rregullores së Programit GJLQG (*Përgjegjësitë e departamentit ndaj studentit, pika 3)*<br>*a. Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek i jep studentit gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kërkesat e programit të studimit në të gjitha hallkat e drejtimet e tij.*<br>*b. I garanton studentit mësimdhënie të kualifikuar, literaturë sa më të gjerë dhe bashkëkohore për lëndët e planit mësimor, mjedisin e duhur për pjesëmarrje në kërkim shkencor dhe veprimtari të tjera. Mbi të gjitha transparencë dhe marrëdhënie sa më demokratike.*<br>*c. Nxit studentët të marrin pjesë në veprimtaritë e programit dhe të universitetit.*<br>*d. Asiston studentin në plotësimin e kërkesave që lidhen me arritjen e objektivave të programit të studimit. I krijon kushte të përshtatshme, mjediset, akses interneti, i vë në dsipozicion bibliotekën dhe teknologjinë e informacionit.*<br>**[Evidenca 1.10. Rregullore e Programit të Studimit Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, neni 38, faq. 13]**<br>Studentët e programit të studimit në fjalë mund të përdorin abonimet on line të universitetit si dhe mjediset e bibliotekës së universitetit.<br>Ky informacion u vihet studentëve në dispozicion nga personeli akademik dhe përgjegjësi i njësisë bazë në ditët e para të fillimit të studimeve në UGJ.<br>**[Evidenca 4.7. Inventari i DGJLQG; Evidenca 4.8.1. Fondi i librave të bibliotekës së DGJLQG; Aneks Tabela: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)** |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Po. Sipas **Rregullores së studimeve në UGJ neni 64, faq. 34** studenti në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, vlerësohet me notë.<br>Me mbarimin e procesit të kontrollit të dijeve, bëhet vlerësimi i studentit. Çdo pjesëtar i komisionit vendos notën ose pikët e vet (sipas vendimit që është marrë paraprakisht për vlerësim me pikë apo notë ) për çdo kandidat diplomimi.<br>Në prani të kandidatit dhe të gjithë komisionit kryetari shpall vendimin mbi vlerësimin e diplomantit. Kur kemi punim diplome për vlerësimin merret në konsideratë edhe vlerësimi i udhëheqësit edhe punimi i studentit.<br>Për vlerësimin e diplomantit me provim përfundimtar mirren parasysh përgjigjet e pyetjeve të tezës që ka marë me zgjedhje.<br>Vlerësimi i punimit të diplomës ose i provimit të përgjithshëm përfundimtar pasqyrohet në procesverbalin përkatës i cili nënshruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore.<br>Procesi i vlerësimit për të dy rastet është i lirë dhe i hapur.<br>**[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 2,3. Neni 64]** |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në bazë të Rregullores së FESHSH, neni 41 Pajisja me diplomë dhe suplement diplome "*1. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka shlyer provimin e përgjithshëm përfundimtar apo ka mbrojtur punimin e diplomës pajiset me diplomën përkatëse, shoqëruar me fletën e notave dhe me suplementin e diplomës.*<br>*3. Diploma nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit.*<br>Me kërkesë të vet studentëve në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. |

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca 1.5 Rregullore e FESHSH, neni 41; Evidenca 2.6. Model diplome Bachelor në Gjuhë letërsi dhe Qytetërim Grek; Evidenca 2.6.1. Model suplementi i diplomës]** |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | I gjithë dokumentacioni në lidhje me studentët ruhet në sekretarinë mësimore të FESHSH. Duke nisur nga momenti i rregjistrimit të tij në institucion ku arkivohen të dhënat personale dhe në vazhdim rregjistrohet dhe arkivohet e gjithë veprimtaria e tyre deri në diplomim. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.<br>Sipas Rregullores së FESHSH Krau XIX, neni 46, pika c Në Sekretarinë mësimore ruhen:<br>Procesverbalet e provimeve<br>Regjistrat e regjistrimit të studentëve, amzat, regjistrat e diplomimit dhe çdo regjistër tjetër që lidhet me studentët e regjistruar.<br>**[Evidenca 1.5. Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Kreu XIX, neni 46; Evidenca 1.4. Rregullore e studimeve në UGJ, kreu X nenet 70-4; Evidenca 5.30. Rregullore e sekretarisë mësimore. ]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Bazuar në Statutin e UGJ-së **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Nenet 41, 42]** funksionon Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruatjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative parashikuar në Rregulloren e saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ajo ndjek në tërësi problemet dhe detyrat që lidhen me burimet njerëzore, komunikimin, shërbimet juridike, standartet dhe kurrikulat, shërbimet bibliotekare-arkivore dhe studentore, kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë. **[Evidenca 3.3 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 4, 5; Evidenca 4.1 Model dosje personeli]**<br>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marredhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshope. **[Evidenca 3.3 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 17]**<br>Në praktikën e UGJ-së roli i përcaktuar nga kriteri 1 për Njësinë Bazë i është atribuar disa strukturave të mëvetësishme dhe bashkërenduese. Njësia Bazë ruan dhe përditëson të dhëna të karakterit akademik që lidhen me organizimin e pavarësinë së vet akademike, si, sylabuset, ngarkesat, planifikimi i veprimtarive etj. Përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semester si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik etj. Një serë të dhënash të po kësaj fushe i përcillen FESHSH, dhe çdo instance tjetër të ngarkuar nga UGj për mbarrëvajtjen akademike e financiare, Rektoratit, zyrës së kurrikulës, statistikës, marrëdhëniet me jashtë etj.<br>**[Evidenca 1.5. Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH Neni 46, gërma b; Evidenca 1.9. Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek Neni 13, 14; Evidenca 4.2. Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik të DGJLQG; Evidenca 4.3. Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik të DGJLQG]**<br>Në Statutin e UGJ-së, Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e FESHSH si dhe Rregulloren e DGJLQG përcaktohen edhe detyrat e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor.<br>**[Evidenca1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" , Neni 45, pika 3; Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e UGj-së, Neni 41; Evidenca 1.5 Rregullore e Njësisë Kryesore FESHSH, Neni 15; Evidenca 1.9 Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qyteterimit Grek, Neni 12]** |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivin, dhe me Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. **[Evidenca 4.11 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Evidenca 4.12 Udhëzues Privatësia]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Rekrutimi i personelit akademik bëhet nga UGJ-së. Legjislacioni kombëtar është Kushtetuta, Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë. Aktet e brendshme rregullatore janë Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe Rregullorja për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej". **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 56; Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e UGj-së, Nenet 27, 29; Evidenca 2.8 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8, 9]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | UGJ në aktet e veta normative për rekrutimin e personelit akademik dhe të çdo kategorie tjetër punonjësish, parashikon procedura dhe kritere. Kriteret janë të përgjithshme dhe specifike. **[Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e UGj-së, Neni 27]**<br>Procedura e parashikuar në aktet e veta normative nisen nga Njësia Bazë, e cila duke u nisur nga nevojat e veta për realizimin e programit të studimit, i drejtohet Dekanatit të Fakultetit me kërkesë për rekrutim personeli, me kohë të plotë, ose të pjesshme. **[ Evidenca 4.4 Propozim për personel akademik me kohë të plotë, 4.26 Kërkesë për plotësimin e vendit vakant me personel me kohë të plotë; Evidenca 4.5 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar].**<br>Njësia Bazë argumenton arsyet dhe qëllimin për personel akademik dhe përcakton edhe kriterët të cilat në një pjesë janë të unifikuara dhe të përgjthshme. Parashikohen edhe kritere specifike të cilat janë në varësi të programit të studimit.<br>Në rastin e NJBGJLQG kriteret e përzgjedhjes janë edhe specifike që burojnë nga natyra e programeve të studimit të kësaj Njësie Bazë nga përmbajtja e tyre, struktura lëndore, gjuha, misioni, objektivat etj. Pasi miratohet kërkesa për punësim nga Dekanati, kërkesa i përcillet Rektorit të Universitetit, ku pas miratimit, publikohet në Buletinin e Prokurimeve Publike, në faqen zyrtare Web të Universitetit, si dhe në mjetet e tjera të informimit publik. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | UGJ-ës me pikënisje Njësinë Bazë, ndjek procedura rekrutimi të rregulluara me aktet e veta normative. Vlerësimi i kandidaturave për rekrutim mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike. Ato inicohen nga Njësia Bazë që paraqet kërkesën për vendin vakant. Nisen nga qëllimi i garantimit të përzgjedhjës së personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Këto kritere përcaktohen nga Njësia Bazë si pjesë integrale e kërkesës drejtuar Rektorit. Pas aprovimit të kërkesës dhe kriterëve nga Dekani, ato i përcillen Rektorit i cili ka të drejtë t'i ndryshojë kriterët. Rektori shpall vendin vakant në Buletinin e Prokurimeve Publike dhe në mjete të tjera informimi publik. Pas mbylljese së afatit të aplikimit, Rektori ngre komisionin *ad hoc* për vlerësimin e kandidaturave të kryesuar nga përfaqësuesi i rektoratit. Njësia Bazë që paraqiti kërkesën përfaqësohet nga tre anëtarë. Në Komision merr pjesë dekani i fakultetit përgjegjës ose përfaqësuesi i tij. Struktura e manaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin *"ad-hoc"* në zhvillimin e procedurave konkuruese.<br>**[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 33, gërma "h"; Evidenca 4.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DGJLQG]** Procedurat e punësimit të personelit akademik me |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

EA

| | |
|---|---|
| | kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar përputhen me aq sa është e mundur me procedurat e personelit akademik me kohë të plotë. Komisioni *"ad-hoc"* ngrihet nga Dekani i Fakultetit. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 52, pika 3; Evidenca 4.6.1 Ngritja e komisionit ad hoc për pranimin e një anëtari staf akademik]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | po |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Në përputhje me rregulloret e brendshme dhe legjislacionin në fuqi institucioni siguron kushtet e nevojshme pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin për kryerjen profesionalisht të detyrimeve institucionale. **[Evidenca 4.10 Infrastruktura e UGJ]** Ky mjedis është i garantuar në terma të infrastrukturës fizike, të asaj teknologjike dhe literature.<br>Në rastin e NJBGJLQG, zotëron një mjedis për akomodimin e personelit akademik me të gjitha mjetet e nevojshëm. Çdo anëtar i stafit akademik ka PC-në e vet dhe akses në internet. Njësia Bazë ka mjetet e duhura audiovizuale dhe komunikimi. Ka dhe bibliotekën e vet të veçantë, të dytën në UGJ-ës **[Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit të tij me qëllim aftësimin e tij në përputhje me përcaktimet e Statutit të tij dhe të standardeve. Stafi inkurajohet të marrë pjesë në projektet e ndryshme shkëmbimore, në konferenca, dhe në aktivitete të tjera në funksion të rritjes së tyre profesionale. Të gjitha trajnimet afishohen në faqen zyrtare. Përmbajtja e tyre lidhet me nevojat e identifikuara të stafit akademik. Akoma institucioni përmes email-eve zyrtare i përcjell gjithë personelit akademik të përhershëm dhe me kohë të pjesshme mundësi për pjesëmarrje në konferenca, seminare etj.<br>Për më tepër, stafi akademik inkurajohet shumë për të marrë pjesë në projekte të shkëmbimit të stafit "Erasmus+" me universitete të tjera partnere dhe veçanërisht me Universitetet e Greqisë: Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, Universitetin e Selanikut, Universitetin e Janinës, Universitetin e Kretës, etj. Nëpërmjet këtyre pjesmarrjeve anëtarët e personelit kanë shkëmbyer përvoja dhe janë njohur me politikat e menaxhimit dhe strategjitë e zhvilluara në institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë në Europë dhe jashtë saj. **[Evidenca 1.12. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ-së; Evidenca 1.13.1. Lista e mobiliteteve të UGJ-së; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 20 Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit]** Gjithashtu institucioni ofron kushtet e nevojshme dhe mundësinë për të botuar në Periodikun ***"Kërkime Universitare"*** për Shkencat Shoqërore, të Edukimit dhe Ekonomike (ISSN:2226-082X) (buletinifeshsh@uogj.edu.al).<br>Edhe Njësia Bazë inkurajon anëtarët e stafit akademik në kualifikimin e vazhdueshëm të tyre me:<br>1. Fitimin i gradave dhe titujve brenda dhe jashtë vendit.<br>2. Stimulimin e pjesëmarrjes në veprimtari shkencore akademike, kërkimore e botuese.<br>3. Koordinimin e iniciativave të veta me veprimtaritë e UGJ-së. |

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca 1.11 Strategjia e zhvillimit të DGJLQGr 2020 -2025; Evidenca 4.1 Model dosje personeli; Evidenca 3.12 Informacion për organizimin e një konference ndërkombëtare periodike MGDLT-8; 3.12.1 Informacion në lidhje me mbrëmjen poetike të poezisë greke; Evidenca 3.13 Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarrje në aktivitete pedagogjike të DGJLQGr të pedagogëve nga Universitete Greke; Evidenca 3.13.1.Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 17. 11. 2017; Evidenca 3.13.2 Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 22.5.2017; Evidenca 3.13.3 Seminaret trajnuese për mësuesit nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore/Greqi 24. 07. 2017; Evidenca 3.13.4 Seminari 6 – mujor për metodat e mësimdhënies]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | UGJ aplikon forma bashkëkohore të mësimdhënies, asiston dhe mbështet nismat për metodat inovative nga stafi akademik. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 dhe pas saj janë organizuar trajnime për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie përmes sistemit të brendshëm informues Teams. **[Evidenca 3.2.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.2.12 Grafiku i konsulltimeve për një javë për periudhën e pandemisë 2021; Evidenca 3.2.13 Informacion në lidhje me platformën që do të aplikojë stafi akademi për zhvillimin e mësimit në distancë]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Institucioni përdor të gjitha burimet e veta njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit "Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek". Stafi i kualifikuar është i angazhuar në mësimdhënie, në drejtimin akademik të formimit të studentëve, në realizimin e leksioneve, prezantimeve, projekteve, eseve, provimeve, sikurse dhe në punë administrative për zbatimin me sukses të programit. NJB në çdo fillim viti akademik planifikon kohën vjetore të punës për çdo anëtar të personelit akademik ku përfshihet ngarkesa mësimore **[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit bachelor dhe në një vit akademik; Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]**, kërkimin shkencor dhe angazhimin institucional në nivel njësie bazë e fakulteti. Stafi akademik angazhohet në përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe në përgjithësi të NJB-së që kanë të bëjnë tri shylla: anën akademike, koordinimin e inisiativave në mbarëvajtjen e arsimit në MEG, dhe promovimin e kulturës greke. **[Evidenca 1.11 Strategjia e zhvillimit të DGJLQGr 2020 -2025]**. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçëm sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën | UGJ-ës ushtron aktivitetin e tij në 3 (tri) godina universitare. Godina A me sipërfaqe 3255.5 m², Godina B me sipërfaqe 1937 m² dhe godina C me sipërfaqe 729.6 m². **[Evidenca 4.10 Infrastruktura e UGJ]** Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. **[Evidenca 4.10.1 Leje higjeno sanitare]** Godinat plotës me |

| | |
|---|---|
| specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit.<br>UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluara bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. **[Evidenca 4.10.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri]**<br>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (një motogjenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë.<br>Bazuar në Raportin e MAS-së mbi "*Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024*", UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 $m^2$/student, llogaritur kjo në dy fasha orare kjo normativë shkon në 5 $m^2$/student. **[Evidenca 4.13 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024]**<br>UGJ siguron mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre".<br>**[Evidenca 4.14 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017; Evidenca 4.13 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; Evidenca 4.10 Infrastruktura e UGJ; - ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë]**<br>Veprimtaritë mësimore si leksionet dhe seminaret e programit të studimit, zhvillohen në Godinën A dhe në Godinën B. Për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike Njësia Bazë disponon edhe sallën e Bibliotekës së saj, e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme (literaturë, kompjuter, printera, aparat fotokopjues dhe skanimi **[Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG]** |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | NJBGJLQGR disponon kapacitet infrastrukturor dhe mjedise të mjaftueshme për pritjen e studentëve dhe akomodimin e personelit akademik të programit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek". Ka në dispozicion mjedise mësimore, si klasa, bibliotekën e saj me mjedise studimi, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik. Ato janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet, që ndihmojnë në drejtim të përgatitjës dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik. Në funksion të zbatimit të metodologjive inovative të mësimdhënies-mësimnxënies, janë vënë mjete të teknologjisë bashkëkohore. Çdo anëtari stafit akademik ka PC e vet dhe PC të tjera për përdorim të lirë me akses për studentët. Njësia Bazë ka në dispoziocion tre printera, dy aparate fotokopjimi dhe skanimi, aparat videoprojektori dhe lidhje kabllore dhe valore interneti.<br>**[Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG]** |



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR - REPUBLIKA E SHQIPERISE

EA

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Programi i studimit "Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek", përbën përgjegjësi eksluzive të NJBGJLQGR dhe ka veçoritë e veta të përshkruara që në Standartin e parë dhe në standartet në vijim. Lëndët e programit përzgjidhen nga fushat bazë të gjuhës greke, të letërsisë dhe të kulturës greke, me destinacion po të veçantë punësimi për të diplomuarit.<br>Procesi akademik zhvillohet në dy kategori mjedisesh. Kategoria e parë lidhet me mjediset eksluzive për këtë program. Vendin kryesor e zë biblioteka. E pasur në iventarin e librave, në gjuhën greke dhe të huaj, për të asistuar përmbajtjen e programit dhe jo vetëm. Eshtë e pajisur me mjete të nëvojshme teknologjike dhe ndërkohë me akses në shumë Datebases greke dhe të huaja që lidhen me gjuhën letërsinë dhe kulturën greke.Aksesi elektronik është i mundur dhe me bibliotekën e Universitetit të Janinës.<br>Në kategorinë e dytë përfshihen mjediset e UGJ-së, si psh salla qëndrore e informatikës, laboratori i arkeologjisë, i Gjuhëve të huaja, apo dhe mjedise të tjera të cilat janë të pajisura plotësisht me të gjitha aparaturat dhe mejtet e nëvojshme për aftësimin teorik e praktik të studentëve dhe ploitësimin e objektivave të programit të studimit.<br>**[Evidenca 1.9 Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit grek, Neni 15. Biblioteka e DGjLQGr; Evidenca 4.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Njësia jonë Bazë për shkak të natyrës së programit të vet të studimit nuk disponon një laborator të tillë. Plotësimi i nevojave për lëndë, tema apo veprimtari të caktuara bëhet duke përdorur mjediset adekuate të UGJ-së, të cilat modernizohen me pajisjet të teknologjisë të informacionit vit pas viti. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Programi Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek" nuk parashikon praktikën e detyruar profesionale. Ajo është e përfshirë në programet e ciklit të dytë Master Profesional. **[Evidenca 3.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022]** Ndërkohë për zhvillimin e veprimtarive të tjera praktike, NJB disponon hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e tyre. Për raste më të gjera përdorën mjedise të UGJ-së që kanë për destinacion pritjen e veprimtarive të kësaj natyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Studentët dhe stafi akademik i NJBGJLQG kanë në dispozicion dy biblioteka, Bibliotekën e Universitetit dhe Bibliotekën e Departamentit, të cilat ndodhet në Godinën C të Universitetit. Ata dhe stafi akademik kanë akses të plotë në burimet e bibliotekave mësimore dhe në burimet online bibliotekare sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga institucioni. Biblioteka Qendrore disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka disponon fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjëndet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek". Biblioteka shërben edhe si sallë interneti. **[-ANEKS-Tabelat Përmbledhës Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, Informacion për bibliotekën "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**<br>Biblioteka e Departamentit është pjesë e rëndësishme e infrastrukturës akademike e shkencore të NJB. Ajo është një bibliotekë në funksion të implementimit të programeve të studimit të Departamentit, si edhe në |

| | |
|---|---|
| | shërbim të lëxuesve të tjerë brenda dhe jashtë Universitetit. Biblioteka është e pajisur me literaturë të drejtpërdrejtë për programet e studimit dhe literaturë tjetër ndihmëse në gjuhën greke. Studentët dhe stafi kanë të drejtë të huazojnë literaturën që u duhet jashtë mjediseve fizike të bibliotekës. Ajo ka në fondin e saj mbi 900-1000 tituj librash, (tekste, monografi, manuale, fjalorë, enciklopedi). Pasurimi i bibliotekës me literaturë të re dhe bashkëkohore që lidhet me programin e studimit dhe jo vetëm mbetet një detyrë dhe sfidë për t'u përmbushur nga institucioni. Pasurimi i saj deri me sot bëhet në bazë të dhurimeve të ndryshme sidomos nga universitetet greke. Biblioteka administrohet nga një anëtar i stafit Akademik. Që prej vitit akademik 2015-16 biblioteka mban lidhje me shtëpinë botuese Elikranon–Athinë dhe në bashkëpunim me të ka marrë përsipër të botojë dhe ribotojë, libra, revista, gazeta dhe çdo botim tjetër që prej shekullit 17të deri në ditët tona. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi përfshihen edhe botimet e Departamentit si edhe botime të krijuesve të tjerë nga Minoriteti Etnik Grek.<br>**[Evidenca 4.8 Rregullore e Bibliotekës Akademike; Evidenca 1.9 Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit grek, Neni 15. Biblioteka e DGjLQGr; Evidenca 4.23 Kërkesë administratorit për blerje librash; Evidenca 4.24 Kërkesë për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 4.25 Kërkesë për financim nga Ministria e Kulturës së Greqisë]**.<br>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabartë në përdorimin e tyre. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambjentet e Bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit. **[Evidenca 4.8.2 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit; Evidenca 4.8.3 Kartelë personale e përdoruesit për bibliotekën e DGJLQG]**<br>UGJ ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e librarive elektronike ku ata mund të shfrytëzojnë literaturë në gjuhën greke dhe në gjuhë të tjera. **[-ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, Informacion për bibliotekën "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës së NJB dhe asaj të UGJ-së është multidisiplinare. Në bibliotekat gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi. Të interesuarit gjejnë në biblioteka literaturë për çështje të përgjithshme, për gjuhën, letërsinë dhe qytetërimin grek, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, ekonominë dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuara si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin. Në bibliotekën e NJB ekzistojnë kategori të ndryshme të librave që vërtet përbëjnë bibliografi për programin e studimit si: Literaturë e gjithanshme për antikitetin greko-romak, literaturë për Bizantin, studime dhe vepra për autorë të letërsisë moderne greke, për folklorin, vepra të autorëve të MEG si edhe botime të vet NJB. **[Evidenca 4.8.1. Fondi i librave të bibliotekës së DGJLQG]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentet shërbimin "on-line" të Bibliotekës "ULibrary".**[https://ulibrary.rash.al/]**. Në faqen zyrtare ueb të UGJ -së, **[https://uogj.edu.al/biblioteka-online/]**, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë "on-line", literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet |

| | |
|---|---|
| | e manualit përkatës. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. **[Evidenca 4.8.4 Biblioteka, Manuali i përdorimit]** Gjithashtu, nëpërmjet abonimit të Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare online, studentëve/pedagogeve ju ofrohet mundësia e aksesimit të literaturës në gjuhë të huaj. **[-ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, Informacion për bibliotekën "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim të bibliotekës nga të gjithë studentët. **[-ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, Informacion për bibliotekën "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** Në bibliotekën e NJB ndodhen dhe dy kompjutera ku studentët mund të përdorin programet dhe mjetet mësimore të Microsoft Office për të shkruar detyrat dhe punimet e tyre, apo të përdorin motorët e kërkimit. **[Evidenca 4.7 Inventari i DGJLQG]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij online **[-ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, Informacion për bibliotekën "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 4.23 Kërkesë administratorit për blerje librash; Evidenca 4.24 Kërkesë për pasurimin e bibliotekës; Evidenca 4.25 Kërkesë për financim nga Ministria e Kulturës së Greqisë; Evidenca 4.8.5 Letër falenderimi për pasurimin me tituj të bibliotekës së DGJLQG 2016, 2020, 2021]** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik ditët e javës, e Hënë-e Premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8.00--19.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Për çdo student ka kartelë personale të përdoruesit.<br>**[Evidenca 4.8 Rregullore e Bibliotekës Akademike; Evidenca 4.8.2 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e | Organizimi administrativ në lidhje më studentët në UGJ nuk parashikon sekretari me vete për çdo njësi bazë, apo program studimi, por një sekretari të përgjithshme dhe sekretari të fakulteteve. UGJ është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Nëpërmjet platformave të ofruara prej tyre |

| | |
|---|---|
| tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UGJ-së, si dhe matrikullimi i studentëve, bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UGJ.<br>UGJ në përputhje me Neni 101 të Ligjit te arsimit te lartë, Statutin e UGJ-së **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 44]** si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore **[Evidenca 5.30 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4]** administron:<br>• Regjistrin themeltar të studentëve.<br>• Regjistrin e arritjeve akademike.<br>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.<br>UGJ disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (student, pedagog, etj.) **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]**<br>Disa nga funksionalitetet kryesore të kësaj platforme janë:<br>**Hapësira didaktike**: Struktura Akademike, Menaxhimi i Karrierës së Studentit, Provime dhe Tema e Diplomës.<br>**Hapësira administrative:** Pranimi dhe Regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i Studentëve.<br>**Tarifat**: Menaxhimi i Tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha Financiare<br>**Diplomimi:** Provimet e Shtetit, Praktika studentore, Diploma Online dhe Suplementi.<br>Në UGJ ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elekronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët **ESSE3** me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3. **[Evidenca 4.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3]** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Në UGJ menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretarisë Protokol. Menaxhon:<br>• regjistrin themeltar<br>• dosjet personale të punonjësve<br>dhe çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori, apo Administratori i Universitetit.<br>**[Evidenca 3.3 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 3, 4, 5]**<br>Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 82]**<br>Bazuar në Rregulloren e FESHSH **[Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 46]**, FESHSH dhe DGJLQG ruan me kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj. **[Evidenca 4.1 Model dosje personeli; Evidenca 4.3 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik]** |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi i menaxhimit nuk administrohet nga Njësitë Bazë në UGJ, por përbën një shërbim qëndror dhe të unifikuar. UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]**, u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve të Programit të Studimit |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË – UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek".<br>Personeli akademik dhe ndihmës akademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogaritë e tyre, ku shfaqen të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimet në çdo lëndë etj. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj. janë të publikuara edhe në faqen zyrtare ueb të UGJ -së. **[https://uogj.edu.al/]** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes Web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365. Microsoft Teams, LearningKey etj.<br>**[https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/; Evidenca 3.2.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca 3.2.6 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët]** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Platformat elektronike (ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey) garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Njësia jonë Bazë ka mjetet e veta të informimit publik. Një faqe interneti që pasqyron gjithë veprimtarinë akademike-shkencore, kërkimore, botuese, kulturore të Njësisë Bazë dhe një faqe tjetër në fb nëprmjet të cilës arrihet komunikimi i përditësuar me studentët, ish studentë, dhe komunitetin.<br>Po ashtu, bazuar në Statutin e UGJ **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 60]**, NJBGJLQGR publikon në faqen zyrtare të web të UGJ-së, dhe të FESHSH *https://uogj.edu.al/fakultetet/fakultetin-e-edukimit-dhe-shkencave-shoqerore/* si edhe në faqen zyrtare të Departamentit *http://www.tmimaelinikon.com/* , informacione dhe materiale të kategorizuara si më poshtë:<br>• Informacione që lidhen me programin e studimit si: Rregullorja e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor i tij, Struktura mësimore, Orari mësimor, kalendari i provimeve etj,<br>• Informacione mbi NJBGJLQGR dhe personelin akademik të tij.<br>• Informacione mbi aktivitete të ndryshme etj të cilat janë në gjuhën shqipe dhe angleze. **[http://uogj.edu.al/]**<br>Njoftimet në faqen zyrtare të Departamentit janë gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | po |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Në UGJ-ës ana financiare është e përqëndruar dhe nuk parashikohet buxhet për çdo Njesi Bazë. Ekskluzivitet të administrimit qëndror përbëjnë edhe kostot për çdo program studimi dhe për mbështetjen financiare të programit të studimit. Pjesëmarrja e njësisë bazë arrihet përmes propozimeve në hartimin e buxheteve vjetore. Me këtë manaxhim financiar mbulohet edhe kostot për mbarëvajtjen e programit tonë të studimit.<br>UGJ harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti financiar bazohet në Statutin e UGJ dhe bëhet sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.<br>**[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 103]**<br>Projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori i UGJ-së, mbi bazën e propozimeve të Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, mbështetur në Planin Strategjik të zhvillimit të UGJ-së, Planin buxhetor afatmesëm, dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik.<br>**[Evidenca 4.9 Kërkesë për bazë materiale DGJLQG; Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025, Kreu *Financat dhe Burimet Financiare,* faqe 34; Evidenca 4.20 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025]** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | Siç u theksua dhe në përgjigje të kriterit të mësipërm (1) kërkesat e paraqitura në kriterin në fjalë (2) janë ekskluzivitet i strukturave qëndrore të manaxhimit financiar të UGJ-së dhe Njësitë bazë ashtu si edhe NJBGJLQG marrin pjesë nëpërmjet propozimeve dhe kërkesave për veprimtari, projekte, botime, pjesëmarrje në kongrese, pasurim biblioteke, abonime etj. që nuk janë pjesë e drejtpërdrejtë e mbulimit financiar të procesit akademik në auditor.<br>**[Evidenca 4.16 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.17 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.18 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit, Tabela 18]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyre periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, sipas kërkesave ligjore në fuqi ku paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet.<br>**[Evidenca 4.16 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.17 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.18 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]**<br>Gjithashtu në mënyre periodike UGJ, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS.<br>**[Evidenca 4.19 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve; Evidenca 4.21 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca 4.22 Raport i MAS AUDIT 2022]** |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Kërkesat e këtij kriteri nuk përbëjnë objekt për mënyrën e organizimit të financimit të programeve të studimit në UGJ. Sipas praktikës së UGJ-së Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatin Akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit. |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca 4.16 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.17 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.18 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Burimet e financimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, si institucion publik janë dy :<br>• Financim nga buxheti i shtetit.<br>• Financim nga të ardhurat dytësore të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve si: tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni ndaj të tretëve<br>Më qëllim mirëmenaxhimin e këtyre fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit.<br>**[Evidenca 4.16 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca 4.17 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca 4.18 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet** e ndryshme në 3 vitet e fundit Tabela 18] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Pranimi i studentëve të rinj dhe procesi i ndjekjes së sudimeve prej tyre brenda një cikli të plotë në UGJ bazohet në një politike korrekte, hartuar dhe aplikuar prej tij në zbatim të kornizës ligjore korresponduese në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Këto dispozita dhe politika institucionale gjejnë reflektim në Statutin dhe rregulloren e UGJ **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 62; Evidenca 1.2 Rregullore e Brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 49]** dhe në aktet analoge të njësive të linjës, fakultetit njësisë bazë, siç janë statuti dhe rregullorja e FESHSH dhe rregulloret e programeve të studimit dhe ato të njësive bazë. **[Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Neni 17; Evidenca 1.9 Rregullore e brendshme e njësisë bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Neni 21]**<br>Në planin përgjithësues dhe konkret, pikënisja për pranimin e studentëve, lidhet me përcaktimin e kuotave dhe kritereve të praktikuara nga Njësitë Bazë. Fillimi i këtij procesi inicohet me vendim Senati Akademik dhe i paraprin një viti akademik, vitit pasardhës. **[Evidenca 5.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 5.7 Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024; Evidenca 2.3.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca 5.8 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca 5.18.1 Vendim Senatit Akademik për kriteret 2022-2023]**<br>NJBGJLQGR, duke respektuar kriterët e Institucionit dhe duke u nisur nga specifikat e veta, i tregut të punës, i interesave të tjera të komunitetit të cilit i drejtohet dhe mundësive të veta, përcakton kuotat dhe kriteret e veta identifikuese. **[Evidenca 5.3.5 Kriteret dhe kuotat e pranimit të DGJLQGR për vitin akademik 2023-2024]**<br>Kriterët dhe kuotat përcillen për aprovim Dekanatit, i cili nga ana e vet ia përcjell Rektorit për të marrë në vijim aprovimin e Senatit Akademik dhe të dërgohen në MAS. Kriteret dhe kuotat bëhen publike në faqen zyrtare të UGJ https://uogj.edu.al. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe të gjitha aktet normative të UGJ-së dhe të njësive të tjera përbërese të tij, përfshirë e NJBGJLQGR, në lidhje me procedurat nga hyrja në dalje të studentit garantojnë dukshëm barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Ky realitet vërtetohet si nga dokumentacioni në fuqi dhe i zbatuar, por më shumë nga praktika dhe përvoja afatshkurtër dhe afatgjatë, pasi nuk egziston e as është provuar që të ketë raste diskrimini, diferencimi, apo shkeljes së barazisë, për të gjitha kategoritë e studenteve, femër apo mashkull, me probleme fizike, mendore apo sjellje të diferencuara, të tilla që lëjojnë ndjekjen e studimeve, të përkatësive të ndryshme fetare apo etnike.<br>Dispozitat e referuara në Statutin e UGJ-së **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 65, pika 6 dhe KREU X]** përshkruajnë qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë.<br>Po ashtu Rregullorja e studimeve në UGJ, **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** dhe aktet analoge të njësive të tjera, pra dhe të NJBGJLQGR **[Evidenca 1.9 Rregullore e brendshme e njësisë bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek]** përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që |

| | |
|---|---|
| | garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët në UGJ dhe veçanërisht në programit Bachelor në "Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek". **[Evidenca 5.11 Dosja personale e studentit nga hyrja deri ne diplomim; Evidenca 2.13. Procedurë e transferimit të studenteve]**<br>Pjesë e kësaj politike dhe praktike përbën dhe mundësia për informacionin e nevojshëm që çdo kandidat për student dhe student, gjen në Mjetet e Komunikimit Publik të UGJ-së dhe në portalin U-Albania. Veçori paraqet studenti në marrëdhënie me programin e studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. **https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/; https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/; https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/; https://www.facebook.com/tmimaellargyr** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe rregjistrimin e studentëve të huaj. | Institucioni pas aprovimit nga MAS të kriterëve dhe kuotave për çdo program studimi të ofruar nga UGJ, publikon në faqen zyrtare të UGJ https://uogj.edu.al kritere të veçanta përzgjedhjeje dhe pranimi në çdo program studimi të kandidatëve për student. Publikimi ndodh përpara çdo viti akademik dhe deri në përfundim të afatit të aplikimit të maturantit për student. **[Evidenca 5.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 5.3 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; Evidenca 5.7 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/]**<br>Propozimet nga Njësitë Bazë, aprovohen në Dekanat, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik. **[Evidenca 5.18 Vendim Senati Akademik për miratimin e kritereve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024]**<br>Këto kritere janë në përputhje me VKM-të në fuqi. **[Evidenca 5.16 VKM Nr.436 për kriterin e mesatares; Evidenca 5.17 VKM Nr.46 i kriterit të mesatares i përditësuar]**<br>Në drejtim të informimit të studentëve kandidatë dhe thithjen e një numri sa më të madh studentësh në vit të parë, UGJ ka ngritur struktura të veçanta dhe ndjek mënyra dhe praktika të ndryshme. DGJLQGR si metodë bazë dhe rezultative ndjek atë të bashkëpunimit me drejtoritë përkatëse të shkollave të mesme dhe kontaktet e drejtpërdrejta me nxënësit, prindërit, mësuesit, komunitetin. Në të është e njohur praktika të thithjes së studentëve që kanë përfunduar studimet parauniversitare në shtete të tjera, veçanërisht në Greqi.<br>Në nivel UGJ-je, një strukturë përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm është Sektori i Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore, i cili çdo vit organizon ditët e hapura me maturantët, e cila ka për qëllim t'i informojë ata mbi programet e ofruara nga UGJ si dhe me facilitetet e tjera që ai ofron. Me qëllim realizimin e politikave të afrimit të maturantëve, UGJ mban lidhje me Drejtoritë Arsimore Rajonale mbi informimin e tyre. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në UG egzistojnë disa mënyra për të bërë të mundur kërkesat e kriterit ose për t'i dhënë mundësi publikut të aksesohet dhe të marrë informacionin e duhur.<br>1. Nëpërmjet publikimeve të vazhdueshme në faqen zyrtare të UGJ-së **[www.uogj.edu.al]** që lidhen me kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, kërkesat për transferim të studimeve, të njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të parimeve dhe praktikave të vlerësimit të dijeve, diplomimit etj. Bëhet fjalë për publikime të akteve rregulluese standarte të UGJ-së për këto probleme, por edhe publikime të aktualitetit. (Sistemi digjital i sekretarisë mësimore) **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]**<br>2. Informacion të drejtpërdrejtë dhe konkret për publikun, ose të interesuarit garantojnë sekretaritë mësimore në nivel institucional apo të fakulteteve dhe strukturave të tjera kompetente në këtë drejtim, zyra Alumni, Këshillimi i Karrierës dhe Vlerësimi i Vazhduar etj.<br>3. Përsa i përket kategorisë së publikut më të interesuar, siç janë kandidatët për studentë ka një informacion më të diferencuar. Programet e studimit të ofruara nga UGJ, u bëhen të ditura paraprakisht kandidatëve për studentë në portalin e maturës shtetërore. Gjithashtu, në portal publikohen edhe kriteret e pranimit, të përcaktuara për secilin program studimi. Njëkohësisht, bëhet |



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | fjalë dhe për botime specifike informuese dhe promovuese, siç janë udhëzues studimesh, albume (rasti i NJBGJLQGR albumi + DVD për 15-vjetorin dhe 25 vjetorin e kësaj Njësie), fletëpalosje, spote publicitare etj. **[Evidenca 5.33 Albumi + DVD për 15-vjetorin dhe 25 vjetorin e NJBGJLQGR]** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Bëhet fjalë për një praktikë pune tani më se të zakonshme. Publikimi para fillimit të vitit akademik të kërkesave e kritereve të përgjithshme e të veçanta të programit të studimit konsiderohet normal të ndodh si në WEB e UGJ-së ashtu dhe me mundësi e mjete të tjera, nëpërmjet botimeve të ndryshme apo edhe kontakteve të drejtpërdrejta me persona të veçantë apo grupe personash të interesuar. **[Evidenca 5.19.1 Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca 5.19 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca 5.20 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve]**<br>Në mënyrë instutucionale UGJ e realizon këtë komunikim nëpërmjet zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, në bashkëpunim me Fakultetet dhe njësitë bazë, përfshirë edhe DGJLQGR. Këto struktura marrin përsipër:<br>- Publikimin në faqen web të UGJ të informacioneve rreth programeve të studimit, përmbajtjes së tyre, diplomave që ofron dhe mundësive të punësimit, kritereve të përgjithshme e të veçanta për ndjekjen e tyre etj. **[http://uogj.edu.al]**<br>- Organizimin e takimeve promovuese, me nxënës maturantë të shkollave të mesme.<br>- Informimin nëpërmjet rrjeteve sociale. Informim nëpërmjet mediave lokale. Informim nëpërmjet fletëpalosjeve dhe posterave<br>**[Evidenca 2.20 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca 5.21 Fletepalosje UGJ; Evidenca 5.21.1 Fletepalosje DGjLQGr; Evidenca 5.22 Poster UGJ]** |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | UGJ-ja, në zbatim edhe të legjislacionit në fuqi, harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere integruese për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta dhe shtresave të margjinalizuara dhe parashikon vende të caktuara në kuotat vjetore pritese të studenteve. **[Evidenca 5.7 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca 5.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024]**<br>Në këtë drejtim duhen përmenduar masat infrastrukturore për aksesimin prej tyre të të gjitha mjediseve dhe mjeteve. Së dyti janë masat për mbështetjen e tyre në përballimin e vështirësive.<br>Risi me vete për UGJ përbën NJBGJLQGR, e cila rekruton kryesisht studentë anëtarë të MEG. Ajo që duhet thenë është se UGJ bën kujdes që të mënjanojë diskriminim pozitiv të kësaj Njësie, studenteve dhe stafit akademik. Një trajtesë e tillë ka bërë që kjo Njësi Bazë të shndërrohet si një rast i veçantë universitar dhe si një aset pozitiv për UGJ, e vlerësuar kështu edhe në akreditimin e jashtme të UGJ-së të vitit 2021. **[Evidenca 5.1.1 Raporti i akreditimit të jashtëm të UGJ- ësë, viti 2021]** |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Sipas rregullores së programit të studimit institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Këto përfshihen në aktet e kritereve dhe kuotave për çdo vit akademik. Afrimi i këtyre studentëve bëhet i mundur përmes procedurave të konvertimit të diplomave si dhe mundësisë së ekuivalentimit të lëndëve e parashikuar kjo sipas statutit.<br>**[Evidenca 5.7 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca 5.4 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca 5.14 Udhëzim-Nr.12-datë-30.6.2023-Për-procedurat-e-aplikimit-dhe-të-regjistrimit-në-IAL]** |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Sipas legjislacionit në fuqi, institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë, ofron mbështetje për uljen apo heqjen e plotë të tarifës së studimit si dhe për rritjen e cilësisë së pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. **[Evidenca 2.10 Vendim Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca 2.9 Vendim Senati** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Akademik për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca 2.9.1 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë]** Në këtë drejtim përbën risi me vete për NJBGJLQGR, pasi për çdo viti siguron donacione nga burime të ndryshme, të cilat përdoren për rritjen e numrit të pranimeve dhe të cilësisë së studentëve në vit të parë, për të garantuar vijimësinë e studimeve dhe për tu ardhur në ndihmë studentëve në nëvojë ekonomike. Kjo është një traditë gati dhjetëvjeçare dhe ka dhenë rezultate shumë të mira. **[Evidenca 5.32 Foto nga dhënja e bursave nga konsullata]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | Po |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në rregulloren e institucionit, në rregulloren e departamentit si dhe në cdo program të studimit përmendet informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. **[Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu V, VI, VII; Evidenca 1.9 Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Kreu IV, VI]** Me fillimin e viti akademik, studentët marrin informacione të rëndësishme, në lidhje me procesin mësimor, planin mesimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës, të publikara në ambjentet e FESHSH si dhe në faqen zyrtare ueb të UGJ-së. **[https://uogj.edu.al/]**<br>Gjithashtu mënyra e vlerësimit analizohet për secilën lëndë në syllabuset tek të cilat jane të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për cdo modul në vecanti dhe modalitet e të diplomimit të tyre. Informimi i studentëve bëhet javën e parë të çdo viti akademik. |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UGJ informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, njohjes dhe transferimit të krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda UGJ-së dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në Statutin e UGJ-së **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 72]** dhe Rregullores së brendshme të UGJ-së **[Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 65; Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Nenet 30, 31]**<br>Pranë sekretarisë mësimore merret informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, si dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në stendat e informimit në UGJ. **[Evidenca 2.13 Procedurë e transferimit të studenteve]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Departamenti i GJLQGR **[Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca 1.9 Rregullore e Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Kreu III, VI]** bazuar ne Rregulloret institucionale informon studentët në fillim si dhe gjatë vitit akademik në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve për çdo lëndë si dhe për programin e studimit në përgjithësi, duke përfshirë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e |

| | |
|---|---|
| | provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu V, VI, VII]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Edhe studentët në programin e studimin Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Për rastin e provimit të përgjithshëm përfundimtar, Njësia Bazë, mbështetur në aktet rregullatore të institucionit dhe të vetë NJB që në fillim të vitit të tretë të studimeve informon studentët për kriteret dhe kërkesat e këtij provimi dhe u vë në dispozicion studentëve një program me pyetje përgjithësuese të lëndëve të të gjithë ciklit të studimit. **[Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, Kreu VI; Evidenca 3.7 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek"; ANEKS – Tabelat permbledhëse. Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022 (Tabela 10)]**<br>Në rregulloren e studimeve të UGJ, Rregulloren e FESHSH-së dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek" përcaktohen qartë kriteret që duhet të plotësojë një student që dëshiron ta mbrojë diplomën me mikrotezë. Në bazë qëndron nota e dy viteve të para të studimeve. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 59, pika 3; Evidenca 1.10 Rregullore e Programit te studimit Bachelor ne Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, Neni 26]**<br>Inisiativa i përket vetë studentit. Ai mund të zgjedh ose të propozojë temën dhe udhëheqësin. Paraqitja e kërkesës nga studenti bëhet që në fillim të vitit të tretë të studimeve. Punimi duhet të ndjek të gjitha procedurat dhe kriterët e paraqitura në manualin e punimit të diplomës të UGJ-së (sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ) dhe kriterët e mbrojtjes të një punimi diplome të parashikuara edhe në Rregulloren e brendshme të programit të studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61; Evidenca 3.7.2 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UGJ organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e maturantëve dhe të interesuarve mbi programet e studimit në UGJ. **[Evidenca 5.19.1 Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve]**<br>UGJ informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese në lidhje me programet e studimit që ofron. **[Evidenca 2.20 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca 2.20.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca 5.21 Fletëpalosje Universiteti; Evidenca 5.22 Poster UGJ; Evidenca 5.21.1 Fletëpalosje DGJLQGR]**<br>Në këtë drejtim Njësia Bazë e GJLQGR, paralelisht me këto rrugë ndjek me sukses ruajtjen e marrëdhënieve bashkëpunuese e informuese me drejtoritë e shkollave nga priten studentët, organizon takime informuese në grupe apo me individë të veçantë, këta maturantë apo prindër, si edhe me faktorë komunitarë. Efektivitetin e këtyre metodave e tregon tendenca në rritje e studentëve në vitet e para të viteve të fundit. **[ANEKS – Tabelat permbledhëse. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

**Standardi V.3**
**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes Rregullores e studimeve në UGJ, Rregullores e UGJ-së si dhe Rregullores e Programit të Studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek" dhe përmes udhërrëfyesit për studentin. [**Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek, Kreu IV; Evidenca 5.27 Udhërëfyesi për studentin**] Informimi i studentëve bëhet në fillim të çdo viti akademik, ku UGJ si edhe DGjLQGr organizojnë takim informues me studentët e vitit të parë të studimeve. Informacionet e mësipërme mund te aksesohen elektronikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare ueb të UGJ-së. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në fillim të çdo viti akademik dhe në vijimësi NJBGJLQGR vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek" çdo informacion, udhëzim apo rregullore që i garanton studentit personalitet dhe autoritet dhe njohje të plotë në lidhje me programin dhe planin mësimor, lëndët, dhe përmbajtjen e tyre dhe gjithë veprimtaritë formuese në ciklin e studimeve.<br>[**Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek; Evidenca 3.1 Plan mësimor Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek 2021-2022; ANEKS – Tabelat permbledhëse. Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek 2022-2023 (Tabela 14)**] Informacion i detajuar për studentët gjendet edhe në faqen zyrtare ueb të UGJ-së. [**www.uogj.edu.al**] |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Në aspektin institucional, kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit e krijon Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar si dhe u shërben studentëve të UGJ-së si urë lidhëse me tregun e punës. [**Evidenca 3.3 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14; Evidenca 2.13.1 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)**]<br>Gjithashtu UGJ-ja merr pjesë në Panaire të ndryshme, studentë prezantohen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm potencialë. [**Evidenca 2.20 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca 2.20.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023**]<br>Njësia Bazë e GJLQGR ka krijuar dhe aplikon një sistem të vetin për të ndihmuar studentët e diplomuar për punësim. Bëhet fjalë për bashkëpunimin me zyrat rajonale të arsimit për të promovuar arsimtarë profesionistë të mirë si edhe aftësinë për të qenë një mjet komunikimi i besueshëm me punëdhenës të tjerë privatë. Kjo ka bërë që NJBGJLQGR të ketë përqindjen më të lartë punësimi të të diplomuarve të vet në rang Universiteti. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Nëpërmjet stendës së Informimit (struktura mësimore, plani mësimor, orari mësimit, kalendari i provimeve, njoftime etj,) pranë Njësisë bazë (Përgjegjësi i Njësisë bazë, titullarët e lëndëve), pranë sekretarisë mësimore, faqes zyrtare Web, njoftimet përmes postës personale elektronike si dhe njoftime në rrjetet sociale, studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

EA

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet dhe eshtë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nëpërmjet faqes zyrtare Web të UGJ, postës zyrtare elektronike si dhe sistemit të sekretarisë mësimore. **[www.uogj.edu.al; https://uogj.pitagora.rash.al/login]** NJBGJLQGR zotëron paralelisht një faqe Facebook me manaxhim të brendshëm në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor, veprimtarisë më të gjerë akademike dhe bashkërendimit dhe bashkëveprimit si Njësi bazë. **https://www.facebook.com/tmimaellargyr** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Letërsi dhe Qytetërin Grek" disponohen nga specialisti i Statistikës në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore të FESHSH **[Evidenca 5.30 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Evidenca 5.12 Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet; Evidenca 2.13.1 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni]** e cila mbledh, përpunon, ruan dhe paraqet informacione statistikore nëse kërkohen bazuar në: rregjistrin themeltar të studentëve; rregjistrin e arritjeve akademike; rregjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave etj. Këto statistika dhe informacione ndihmojnë në përcaktimin e periudhës së lejueshme për çdo student për të vazhduar studimet apo dhe për detyrimet e tjera mësimore e akademike nder vite. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | UGj disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit etj. **[Evidenca 1.18 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2018-2019; Evidenca 1.19 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca 1.20 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Evidenca 5.10 Lista e të transferuarve dhe të larguarve nga UGJ]** |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, akteve shkresore, sistemit ESSE3, tashmë Pitagora, zyrës së Sektorit të Statistikave, të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht, janë të sigurta dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna statistikore janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar. |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe | Njësitë përbërese të UGJ mbështesin veprimtarinë e tyre në akte. UGJ ushtron kontroll periodik në lidhje me të dhe mbështet me akte, këtë kontroll të dokumentacionit pranë Njësive bazë, kryesore dhe Sekretarive mësimore. **[Evidenca 5.23 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2018-2019; Evidenca 5.23.1 Kontroll dokumentacioni viti akademik 2020-2021]** Qëllimi mbetet dokumentimi i situatës, vlerësimi i saktësisë së informacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | | | | |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | NJBGJLQGR në kuadrin e gjithë veprimtarisë institucionale, mbledh të dhëna mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe për përqindjen dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre. **[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); ANEKS-Tabelat Përmbledhëse. Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]** Njëkohësisht analizon këto të dhena dhe del me konkluzione dhe masa përkatëse për të përmirësuar këta tregues, sidomos në aspektin e punësimit. Si kuadër vlerësues mbetet Strategjia e Njësisë Bazë 2020-2025. **[Evidenca 1.11 Strategjia e zhvillimit të Njësisë Bazë të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek 2020-25]** Këto të dhëna dhe konkluzione përbëjnë bazën e raportit periodik për këtë aspekt të veprimtarisë së saj. Raportet e NJBGJLQGR përfshihen në raportet analoge të FESHSH dhe në vijim të UGJ-së, që i pasuron këta tregues me raportet vjetore të Fakulteteve, të Sekretarive mësimore, të Drejtorisë së Shërbimeve Akademike-ndihmës akademike, Zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar. **[Evidenca 1.20 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 2.13.1 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | Po |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Sipas Statutit **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 88, pika 1 gërma b, f, Neni 91]** UGJ inkurajon, përfshin dhe angazhon studentët dhe/ose përfaqësues të tyre në organet kolegjiale të tij. Studentët përfaqësohen në:<br>- Senatin Akademik të UGJ-së **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca 2.15 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]**<br>- Këshillin e Etikës **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 24, pika 3]**<br>- në Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë **[ANEKS-Tabelat përmbledhëse. Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)]**<br>- në të gjitha komisionet zgjedhore në UGJ.<br>- në komisionet e vlerësimit të brendshëm, në vijishmëri dhe për akreditim<br>- vendimarrjen e Njësisë Bazë dhe efektivitetin e punës së stafit akademik<br>- janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë statutin e organizimit dhe funksionimit të tyre **[Evidenca 5.13.1 Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor; Evidenca 5.13 Anëtarët e Këshillit Studentor; Evidenca 5.1 Statuti i Këshillit Studentor]**<br>- kanë Shoqatën Sportive Studentore të tyre. **[Evidenca 5.24 Statuti i shoqatës sportive UGJ; Evidenca 5.24.1 Kërkesë për mbështetje financiare për shoqatën sportive studentore]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në | UGJ bazuar në Statutin e tij **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 88, pika 1 gërma b, Neni 91, pika 5]** garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

EA

| | |
|---|---|
| vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | procesin akademik, zgjedhor administrues. Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik të UGJ-së përfaqësohen në masën 10% shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca 2.15 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]** Studentët marrin pjesë edhe në procese të zgjedhjeve institucionalë duke qënë anëtar të komisioneve zgjedhore. **[Evidenca 5.25 Rregullore e zgjedhjeve të 2020; Evidenca 5.25.1 Vendimet e KIZ]**<br>Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentore, institucionalë dhe në njësi kryesore. **[Evidenca 5.13 Anëtarët e Këshillit Studentor; Evidenca 5.1 Statuti i Keshillit Studentor]**<br>Studentët janë anëtar të Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm e programeve të studimit. **[Evidenca 5.6 Urdhër për ngritjen e GVB të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek]**<br>Studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 24, pika 3; Evidenca 3.5 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]** si dhe pjesë aktive e sondazheve vjetore të studentëve organizuar nga ASCAL dhe e sondazheve të organizuar nga UGJ. **[ANEKS-Tabelat përmbledhëse. Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)]** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | UGJ në Statutin e tij, **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër Çabej, Neni 88, gërma h, Neni 91, pika 5]** garanton që studentët të shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të studimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.<br>Në zbatim të kësaj dispozite dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit, dhe të parimeve të veta të brendshme specifike, NJBGJLQGR i konsideron në mënyrë të natyrshme studentët pjesë të të gjitha proceseve që lidhen me përmirësimin dhe të këtij programi studimi në proces akreditimi, duke reflektuar dukshëm në propozimet e tyre, por edhe duke u mbështetur tek ta, drejtpërdrejt, në bashkëbisedime të lira, nëpërmjet pyetësorëve etj. **[Evidenca 6.3 Pyetesor i Njësisë Bazë GJLQGR]** për t'u shprehur mbi cilësinë e mësimdhënies, për të vlerësuar dhe përmirësuar performancën e stafit akademik. Burim vlerësuese për NJBGJLQGR, mbeten rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve, që pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve, përgatitur nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Në të gjitha Rregulloret institucionale është parashikuar procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve përfshirë këtu edhe procesin e ankimimit të rezultatit nga studenti. **[Evidenca 1.2 Rregullore e brendshme e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VII; Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Kreu VIII; Evidenca 1.9 Rregullore e Brendshme e Njësisë Bazë të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, Kreu III, Kreu VI; Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu V]**<br>Çdo kërkesë, ankimim prej studentëve në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, parashikohet hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Informimit dhe shërbimi i studentëve bëhet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Biblotekare Arkivore dhe Studentore nëpërmjet zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ku mbështesin studentët për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentët e rinj, dhënien e informacioneve për programet, kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve të UGJ-së që diplomohen në nivelin e parë të studimeve për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë në UGJ ose Universitete të tjera, këshillimin e studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 42; Evidenca 3.3 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14]**<br>Gjithashtu edhe nga Sekretaritë mësimore, Zyrës së IT-së, Dejtorisë së Shërbimeve Universitare, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike diplomimin, detyrimet dhe shërbimet financiare, pjesmarrje në mobilitete etj. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Nenet 42, 43, 44]**<br>Një rol të rëndësishëm në informimin dhe mbështetjen e studentëve për çdo problematikë në procesin mësimor ka edhe DGjLQGR.<br>Informimi i studentëve bëhet edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të Universitetit dhe njoftimeve në rrjetet sociale (si Facebook etj.). |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Informimi, këshillimi, ndjekja dhe përparimi i studentëve dhe mbështetja e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nëpërmjet:<br>– Njësisë bazë (Përgjegjësi, titullarët e lëndëve, stendës së Informimit)<br>– Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave Shoqërore<br>– Sektorit të Standarteve dhe Kurrikulave<br>– Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar,<br>– Faqes zyrtare web<br>– Sistemit të Sekretarisë mësimore (Pitagora)<br>– Njoftimi përmes adresave zyrtare elektronikë<br>– Njoftime në rrjetet sociale (Facebook) etj |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, informacion për programet dhe kurrikulat e studimeve, diplomat, informon dhe këshillon studentët e UGJ-së që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë në UGJ ose Universitete të tjera, informon dhe këshillonn studentët për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj. |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyra e Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. [**Evidenca 5.2 Formular gjurmimi të studentëve; Evidenca 5.26.1 Plani vjetor i punës për Këshillimin e karrierës; Evidenca 5.34 Databazë Alumni; Evidenca 2.13.1 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni**] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | Po |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |



REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTER

# VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.**Institucioni harton udhëzues në nivel inistitucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit, lëndëve/moduleve. | UGJ harton udhëzues, manuale dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. [**Evidenca 3.11 Udhëzues institucional mbi metodat inovative te mësimdhenies**].<br>Në Njësinë Bazë të GJLQGr bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, [**Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek Neni25** ] që merr parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin edhe metoda didaktike innovative. Vend të veçantë zënë ato të përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.<br>**[Evidenca 3.11 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit].**<br>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 UGJ ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesimin nga ana e studentëve dhe personelit akademik në këto platforma nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i Universitetit si dhe ndihmoi me udhëzues dhe manuale të nevojshme teknologjike për përdorimin e këtyre platformave [**Evidenca 3.2.1 Urdhër për platformën e mësimit online; Evidenca 3.2.2 Implementimi i platformes se mesimit online Classroom; Evidenca 3.2.3 Implementimi i platformes se mesimit online Edumeet; Evidenca 3.2.4 Implementimi i platformes se mesimit online Office365; Evidenca 3.2.5 Manual i perdorimit te platformes TEAMS per stafin akademik; Evidenca 3.2.6 Manual i perdorimit te platformes TEAMS per studentet; Evidenca 3.2.7 Vendim për format e zhvillimit të procesit mesimor 2020-2021; Evidenca 3.2.8 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca 3.2.9 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021;Evidenca 3.2.10 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021;Evidenca 3.2.13 Informacion në lidhje me platformën që do të aplikojë stafi akademik i DGJLQGREK për zhvillimin e mësimit në distancë**] |
| **Kriteri 2.**Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | Në UGJ ka një ndërgjegjësim se cilësia është « pasaporta e një universiteti modern për njohjen sociale dhe për dallimin ndërkombëtar është përsosmëria akademike». Për materializimin e saj punojnë të gjitha pjesët përbërëse akademike dhe administrative të UGJ-së të përfshira në një strukturë qartësisht të përcaktuar. Për këtë funksionon Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikilave (SSCK) me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standartet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë [**Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,neni 93**] SSCK-ja bazuar në Statutin e UGJ [**Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,neni 94,pika 5**] kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit,vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | |
| --- | --- |
| | ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. **[Evidenca 6.7 Urdhër për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ; Evidenca 6.12 Raport i pyetësorit për procedurën e mësimit on line dhe përcjellja në Fakultete; Evidenca 6.11 Raport vjetor i SSCK për vitin akademik2020-2021; Evidenca 6.11.1 Raport vjetor i SSCK për vitin akademik2021-2022; Evidenca 6.11.2 Raport vjetor i SSCK për vitin akademik2022-2023]**<br>Gjithashtu në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC), strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë[https://uogj.edu.al/kodi-cilesise/] dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë.**[Evidenca 6.9 Vendim i SA për ngritjen e NJSBC; Evidenca 6.10 Vendim i SA për miratimin e NJSBC; Evidenca 6.1 Rregullore e NJSCB, neni 3; Evidenca 6.5 Manual i cilësisë; Evidenca 6.5.1 Vendim i SA për miratimin e Manualit të cilesisë]** |
| **Kriteri 3.**Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UGJ, në zbatim të Statutit të tij, garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve **[Evidenca1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni88, gërma h, neni 91, pika 5]** Përfshirja e studentëve në këtë sistem është shumë-nivelëshe: konsiderohen si aktorë të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së përgatitjes së tyre, si aktorë që së bashku me aktorë të tjerë, janë të angazhuar për të reflektuar mbi cilësinë e shërbimeve që marrin, si aktorë që mund të nxisin personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të reflektojnë mbi shërbimet që u japin atyre. **[Evidenca 6.7 Urdhër për organizimin e pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies në UGJ; Evidenca 6.12. Raport i pyetësorit për procedurën e mësimit on line dhe përcjellja në Fakultete]**<br>Në këtë kuadër Njësia Bazë e GJLQGr për të bërë vlerësimin e brendshëm ka hartuar pyetësorë për të identifikuar dobësitë në procesin e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik. Rezultatet që dalin diskutohen në mbledhjet e Departamentit. **[Evidenca 6.3 Pyetësorët e Njësisë Bazë GJLQGR].**<br>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në organet në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore bazë **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, pika 1 gërma b].** Në Rregulloren e studimeve garantohet e drejta e studentit për përfshirjen e tij në ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes. **[Evidenca 1.4 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 46]**. |
| **Kriteri 4.**Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytet. Grek, u referohet në vijimësi kritereve dhe objektivave të përcaktuara periodikisht nga ana e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së institucionit. Rezultatet e veta i përcjell strukturave përpunuese manaxhuese dhe publikuese të UGJ. Ato nëpërmjet faqes zyrtare Web,[https://uogj.edu.al/transparenca/<br>**[Evidenca 6.2 Vendimi i miratimit per programin e transparencës 2021; Evidenca 6.2.1 Vendimi i miratimit të programit të transparencës 2023 i rishikuar]**, bën publike arritjet në mësimdhënie dhe politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br>**[Evidenca 6.6 Propozime për ngritjen cilësore të punës në institucion dhe në Njësinë Bazë të GJLQGR; Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 3.8 Raporti mbi aktivitetin mësimor-kërkimor DGJ.L.Q.Grek 2021-2022]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.**Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | UGJ, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.<br>Të dhënat e pasqyruara nga mekanizmat e vlerësimit [**Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 3.9.2 Raporti i veprimtarisë shkencore i NJ.BGJ.L.Q.Grek 2021-2022; Evidenca3.10 Plani i veprimtarive akademike, shkencore, kulturore për vitin akademik 2021-2022 të NJ.BGJ.L.Q.Grek** ] shërbejnë si instrumenta të rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.**Institucioni I arsimit të lartë ka politika, strukturadhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | UGJ, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 103, ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit te UGJ 2020-2025]**<br>Në rregulloren e NJSBC [**Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC, neni 5,6,7]** përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br>Në UGJ funksionon Sektori i s\Standarteve të Cilësisë dhe Kurriculave **[Evidenca1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,Neni 93,]** strukturë përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ [**Evidenca 1.7 Organograma e Universitetit Eqrem Çabej]** |
| **Kriteri 2.**Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisënë UGJ përbëhet nga<br>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurriculave, strukturat përkatëse në fakultete, departamente, qeveritë studentore. Kjo strukturë zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Për këtë bashkëpunon edhe me aktore të ndryshëm [**Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025; Evidenca 1.11 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës,Letërsisë dhe Qytetërimit Grek për periudhën 2020-2025**] Në këto dokumenta rregullatore dhe përcaktuese të arritjës së standarteve të kërkuar të cilësisë së brendshme akademike, parashikohet edhe përfshirja dhe bashkëpunimi me studentë dhe faktorë të tretë, bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.<br>Në bazë të Rregullores së NJSBC,[**Evidenca 6.1 Rregullore e NJSCB, neni 4**]<br>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë pranë Rektoratit. Ajo përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, 4(katër) anëtarë janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore,2(dy) përfaqësues administrativ(zyra e kurrikulave dhe kërkimi shkencor) dhe 1(përfaqësues studentor).<br>Në bazë të Statutit të UGJ [**Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,Neni 96,pika 2**] për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional përfshihet një përfaqësues nga organizata studentore.<br>Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre.[ **Evidenca 1.12 Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ**]<br>Në rritjen e cilësisë ka ndihmuar shumë bashkëpunimi që DGJLQGR ka me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore dhe Universitetin e Janinës si në shkëmbimin e eksperiencës ashtu edhe në organizimin e eventeve të ndryshme.[**Evidencë 3.12. Informacion për organizimin e një konference ndërkombëtare periodike MGDLT-8; Evidencë 3.12.1. Informacion në lidhje me mbrëmjen poetike të poezisë greke; Evidencë 3.13. Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarje në aktivitete pedagogjike të DGJLQGr të pedagogëve nga Universitete Greke; Evidencë 3.13.1.Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 17. 11. 2017; Evidencë 3.13.2. Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 22.5.2017; Evidencë 3.13.3.Seminaret trajnuese për mësuesit nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore; Evidencë 3.13.4. Seminarin 6 – mujor për metodat e mësimdhënies;** |
| **Kriteri 3.**Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | UGJ-ja ka marrë akreditimet periodike institucionale, me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. [https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-crtifikata-e-akreditimit/;Evidenca Vendim i Akreditimit Institucional periodik] |
| **Kriteri 4.**Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | Siç u përmend më lart, SSCK bazuar në Statutin e UGJ [**Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej.neni 94, pika 5**] kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, organizon pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional.[**Evidenca 6.12 Raport i pyetësorit për procedurën e mësimit on line dhe përcjellja në fakultete; Evidenca 5.2 Formular gjurmimi te studenteve**] duke evidentuar sukseset dhe të metat me qëllim marrjen e masave për përmirësime në të ardhmen. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |

| Standardi VI.3<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.**Institucioni I arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | UGJ përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin,miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të pare.<br>Në nivel institucional, UGJ harton cdo vit Raportin vjetor bazuar në Raportet vjetore të Departamenteve dhe Fakulteteve ku përfshihen analizat e procesit mësimor dhe kerkimit shkencor **[Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 1.16 Raport vjetor i Njësisë Bazë të FESHSH 2021-2022; Evidenca 3.8 Raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore D.GJ.L.Q.Grek 2021-2022]**<br>Njësia Bazë e GJLQGR monitoron rregullisht realizimin e programit të studimit dhe rezultatet e studentëve të arritura në procesin mësimor, analizon rezultatet mesatare për simestër, ndjek nga afër studentin gjatë praktikës profesionale, si edhe gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës. Të gjitha këto të dhëna përfshihen në raportin në raportin vjetor të Departamentit. |
| **Kriteri 2.**Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Eshtë e vërtetë se raportet vjetore institucionale dhe raportet e vlerësimit të cilësisë nuk përfshijnë në masën e duhut rezultatet e pritshme në të ardhmën e as i mëshohet adresimit të mangësive. Nuk parashikon mjaftueshëm instrumenta për përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët<br>**[Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 1.16 Raport vjetor i Njësisë Bazë të FESHSH 2021-2022; Evidenca 3.8 Raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore D.GJ.L.Q.Grek 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Duke folur për Njësinë Bazë të GJLQGr mund të themi se bëhen përpjekje sipas kuadrit të kërkesës së kriterit, por ato nuk janë të sistemuara, të standartizuara dhe përmanente. Ekzistojnë akte normative rregulluese por gjejnë zbatim të zbehtë. Vlerësimi i Kurrikulës ndodh në një ballafaqim me kriteret e punës së një të diplomuari, me nëvojën e njohjes së diplomës nga një shtet tjetër etj, me kërkesat e kohës dhe në ballafaqim me aktet ligjore, por jo si kërkesë e brendshme e pëmbajtjes lëndore dhe e standartizuar. Më dobët paraqitet çështja e vlerësimit paralel të provimeve, apo edhe testimi lokal i cili mungesa e të cilit mund të ketë dhe arsye objektive.<br>**[Evidenca 1.21 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca 1.16 Raport vjetor i Njësisë Bazë të FESHSH 2021-2022; Evidenca 3.8 Raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore D.GJ.L.Q.Grek 2021-2022]** |
| **Kriteri 4.**Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që | Ndër instrumenta apo metodat e terthorta vlerësimi që përdor Njësia Bazë e GJLQGr janë pyetësorët e ndryshme, testimet dhe sondazhet që përfshijnë studentë, ish studentë të punësuar dhe faktorë të interesuar.<br>Nëpërmjet pyetësorëve që realizohen synohet<br>1. Matja e performancës së stafit akademik të programit të studimit<br>2. Cilësia e mësimdhënies. **[Evidenca 6.3 Pyetesorët e GJLQGR; Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve Aneks Tabela 23]** |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Testimet dhe sondazhet zhvillohen gjatë veprimtarive të ndryshme, takimeve për arsimin, tekstet mësimore, kërkesat për metoda të reja, kualifikimet e mësuesve të Minoritetit Etnik Grek etj | | | |
| **Shkalla e përmbushjessëstandardit** | **Nukpërmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushe tkryesisht** | **Përmbush et plotësisht** |
| | | | | Po |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Njësia bazë e GJLQGr në kuadrin e UGJ-së dhe FESHSH dhe në mbështetje të Akteve normative rregulluese të brendshme, Statutit, Rregullores, Strategjisë së Zhvillimit etj ndërmerr, siguron dhe garanton politika dhe procedura të brendshme të cilësisë edhe me përfshirjen e aktorëve të jashtëm të intereresuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit në drejtim të përmbajtjes së kurrikulës, raporteve të përmbajtjes së këtij programi me tendencat zhvillimore të komunitetit etj<br>**[Evidenca 6.8 Propozime për ridimensionimin e marrëdhënieve të universitetit të Gjirokastrës me Universitetin e Janinës]**<br>Aspekt të veçantë përbën bashkëpunimi dhe ballafaqimi me institucione analoge , sidomos jashtë vendit, shprehur në bashkërendimin e përpjekjeve për ta kthyer në program të përbashkët.<br>Sektori i Standarteve Të cilësisë dhe Kurrikulave mund të angazhojë periodikisht ekspertë të jashtëm për çështje specifike ose/dhe specialistë të niveli të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës për konsulencë,ekspertizë ose për çështje të tjera.[ **Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,Neni 94,pika 2]**<br>Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore. Në rast nevoje ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm.<br>**[Evidenca 1.1Statuti i Universitetit Eqrem Çabej,Neni 96, pika 2; Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC, neni 7,pika 2; Evidenca 6.10 Vendim i Sa për miratimin NJSBC; Evidenca 6.9.1 Vendim i SA për miratimin e GVB për programet e studimit ]**<br>Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës,zyra e Alumni, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit Të Vazhduar pranë UGJ është pjesmarrëse dhe promovuese e programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu I punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në | Institucioni–përcakton rolin e individëve, të studentëve dhe të palëve të tjerasi shprehje e interesimit–për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këtë e arrin përmes angazhimit të Njësisë |

| | |
|---|---|
| sigurimin e brendshëm të cilësisë së programi të studimit dhe garan ton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në kombinim me administratën dhe hierarkinë drejtuese, duke aplikuar taktikat më të mira për përmbushjen e Planit Strategjik të Universitetit. Departamenti gjithashtu ngre në parim komisione gjithëpërfshirëse për vlerësimin e punës së tij dhe cilësisë së arritur në programin e tij të studimit. Çdo anëtar ka të përcaktuara detyrat dhe përgjëgjësitë. Duhet pranuar se rezultatet nuk janë të pritshme. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94; Evidenca 3.3 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA , nenet 12,13; Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC; Evidenca 1.9 Rregullore e Njesise baze të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit grek;Evidenca1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek.]** |
| **Kriteri 3.**Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve e programit të studimit. | Në vlerësimin dhe sigurimin institucional të cilësisë së programit të studimit, garantohet me akte normative dhe praktikisht përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore përgjegjëse për programin e studimit, e anëtarëve të personelit akademik, e dhe e studentëve të programit të studimit. Duhet theksuar këtu se dialogu, diskutimi dhe debati i zakonshëm midis anëtarëve të stafit akademik , në kohë të lirë apo dhe në mbledhje të asamblesë së Njësisë bazë reflektohet edhe në aktet informuese të strukturave përgjëgjëse për garantimin e Cilësisë së Brendshme. Pjesëmarrja e studentëve në këtë proces ndodh natyrshëm brenda logjikës së marrëdhënieve të afinitetit, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit. **[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94; Evidenca 3.3 Rregullore per organizimin dhe funksionimin e DSHNA , nenet 12,13; Evidenca 6.1 Rregullore e NJSBC; Evidenca1.9 Rregullore e Njesise baze të Gjuhës.Letërsisë dhe Qytetërimit grek.;Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek.]** |
| **Kriteri 4.**Përfshirja dhe aktivizim i i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhe t të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Në përvojën shumë vjeçare në Njësinë tonë Bazë, në FESHSH dhe në UGJ, nuk janë hasur fenomene të kësaj natyre. Madje vihet re një përpjekje për të mos qenë të drejtpërdrejtë edhe në rastet kur këto struktura vënë gishtin në dobësi, qoftë edhe të dukshme , në aspektin e cilësisë së procesit të mësimdhënies apo të fushës akademike. Aspekti i akteve normative të brendshme janë taksative dhe rigoroze në këtë drejtim **[Evidenca 3.5 Kodi i Etikës]** dhe mbështeten nq Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.si dhe Rregulloren per mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen dhe sigurine e te dhenave personale në UGJ **[Evidenca 4.11 Rregullore per mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen dhe sigurinë të dhënave personale]** |
| **Kriteri 5.**Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që Departamenti ka me institucione të rëndësishme ndërkombëtare si Universiteti Janinës, Universiteti i Maqedonisë Perindimore, pedagogë të jashtëm prej këtyre universiteteve që ofrojnë shërbime mësimore japin mendimet e tyre mbi programin e studimit, cilësinë e studentëve dhe shërbimeve. **[Evidencë 3.12. Informacion për organizimin e një konference ndërkombëtare periodike MGDL E-8; Evidencë 3.12.1. Informacion në lidhje me mbrëmjen poetike të poezisë greke; Evidencë 3.13. Ftesë për leksione të hapura dhe pjesëmarrje në aktivitete pedagogjike të DGJLQGr të pedagogëve nga Universitete Greke; Evidencë 3.13.1.Informacion në lidhje me organizimin e seminarit** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 17. 11. 2017; Evidencë 3.13.2. Informacion në lidhje me organizimin e seminarit kualifikues për mësuesit me Universitetin e Janinës 22.5.2017; Evidencë 3.13.3.Seminaret trajnuese për mësuesit nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore; Evidencë 3.13.4. Seminarin 6 – mujor për metodat e mësimdhënies]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjessëstandardit** | **Nukpërmbushet** | **Përmbushetpjesërisht** | **Përmbushetkryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | Po |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.**Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Të gjitha strukurat që angazhohen me politikën, strategjinë dhe veprimtarinë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshme së Cilësisë, duke filluar nga Njësia Bazë deri tek strukturat përfaqësuese të UGJ-së, kanë për parim bazë transparencën e publikuar. Dhe jo thjeshtë si qëllim në vetvete, por dhe si mundësi për të thelluar sigurimin e brendshëm të cilësisë.<br>Nëpërmjet faqes zyrtare ueb dhe programit të trasparencës [https://uogj.edu.al/transparenca/], në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë UGJ-ja bën publike për të gjithë të interesuarit mekanizmat kontrollues dhe monitoruese dhe rezultatet e tyre si, Planet strategjike të punës në UGJ, Planet e veprimtarive akademike kërkimore shkencore vjetore në UGJ, Raporte monitorimi për cilësinë e programeve të studimit, Raporte të vlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional, Raporte të vlerësimit të jashtëm për akreditimin institucional, Raporte monitorimi të performancës në Universitet etj<br>Kujdesi për sigurimin e transparencës dhe publikimit të instrumentave lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përbën praktikë pune edhe për Njësinë Bazë të Gjuhë,Letërsi dhe Qytetërim Grek. Për këtë Njësia bazë përdor mjetët e veta të komunikimit me publikun që disponon si në faqen e internetit të departamentit http://www.tmimaelinikon.com edhe në fb. |
| **Kriteri 2.**Institucioni I arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | UGJ në publikimin e rezultateve dhe vlerësimeve të programeve të studimit, respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.<br>**[Evidenca 4.12 Udhëzues, privatësia; Evidenca 4.11 Rregullore per mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen dhe sigurine e te dhenave personale; Evidenca 3.5 Kodi i Etikes]** |
| **Kriteri 3.**Rezultatet e vlerësimitduhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Raportet që dalin nga rezultatet e vlerësimit u referohen natyrshëm rezultateve të hasura. Evidentohen njëkohësiht pikat e forta dhe të dobëta dhe mbi bazën e tyre hartohet detyrat dhe afatet për kapërcimin e mangësive dhe dobësive të hasura.<br>**[Evidenca 6.4 Plani i veprimit për Akreditimin institucional periodik; Evidenca 6.6 Propozime për ngritjen cilësore të punës në institucion dhe në Njësinë Bazë të Gjuhës ,Letërsisë dhe Qytetërimit Grek]** |
| **Kriteri 4.**Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Do të përbënte një formalitet rutinor nëse proceset për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së brendshme të UGJ-së apo strukturave të tjera, flasim këtu për Njësinë Bazë të GJLQGr, nuk do t'i shërbenin efektivitetit për përmirësimin vijues të cilësisë. Këtu qëndron dhe thelbi i procesit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 5.**Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentë t për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Departamenti zhvillon veprimtari periodike përmes sondazheve, anketave, plotësimit të formularëve të kontrollit, fushatave informuese për të sensibilizuar dhe për të ndërgjegjësuar personelin akademik dhe vetë studentët mbi rëndësinë e sigurimit të përmirësimit afatgjatë të cilësisë për programet e studimeve. [**Evidenca 6.3 Pyetësori i GJLQGR; Evidenca 1.11 Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek për periudhën 2020-2025; Evidenca 6.6 Propozime për ngritjen cilësore të punës në institucion dhe në Njësinë Bazë të Gjuhës ,Letërsisë fhe Qytetërimit Grek**]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjessëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | Po |

| **Shkalla e përmbushjessëstandardevetëfushës VI** | **Nukpërmbushet** | **Përmbushetpjesërisht** | **Përmbushetkryesisht** | **Përmbushetplotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Po |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

I.

# PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË BACHELOR NË "GJUHË LETËRSI DHE QYTETËRIM GREK"

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. **Cilesia e stafit akademik.** Stafi akademik i NJB ka një përvojë të gjatë pune akademike, kërkimore shkencore, është aftësuar profesionalisht për të përballuar me sukses problematikën specifike të NJB dhe të programit të studimit dhe shfaq një performance të spikatur në drejtim të raportëve me studentët, komunitetin dhe në marrëdhëniet me institucione të huaja akademike dhe jo akademike.
2. **Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik.** Ky process përbën vijimësi dhe dallohet në disa drejtime:a. Në pjesëmarrje në veprimtari akademike e shkencore. b. organizime veprimtarish të karakterit shkencor dhe kulturor, c. botime të ndryshme (artikuj, monografi, tekste universitare, tekste shkollore, botime të tjera d. Kualifikime për tituj dhe grada (një për titull prof, një për pprof as dhe katër për gradën doctor )
3. **Shkalla e lartë e punësimit.** NJBGJLQGR ka përqindjen më të lartë në UGJ përsa i përket punësimit. Gjerësia përmbajtësore e programit /ve të studimit, stimulimi i interesave të studentit për profile të ndryshme punësimi që mundëson programiet e studimit, bashkëpunimi i ngushtë me punëdhenësit, janë drejtimet e punëss që garantojnë këtë përqindje të lartë punësimi.
4. **Kontributi në UGJ, arsimin parauniversitar dhe komunitet.** NJBGJLQGR ka një akord të vlerësuar kontributesh ë UGJ përsa i përket veprimtarive kërkimore shkencore, raporteve me universittet të huaja, sidomos greke, botimeve shkencore dhe të fushave të tjera. Në drejtim të arsimit parauniversitar në MEG ndjek nga afër proceset atje, ka marrë përsipeër kualifikimin e mësuesve, si edhe përgatitjen e teksteve mësimore në gjuhën amtare (mbi 45 tituj) Në drejtim të kontributit ndaj komunitetit në MEG, ka një pjesëmarrje dhe drejton veprimtari të ndryshme kulturore, promovuese, kërkimore. Pjesëmarrja e stafit akademik me fjalime, referime , kumtesa rrit cilësisht çdo veprimtari të tillë.
5. **Infrastrukturë e përshtatshme.** Përveç infrastrukturës së përshtatshme në rang UGJ-je, NJBGJLQGR zotëron mjediset e veta të specifikuara të pajisuara me mjete të duhura. Bën diferencën biblioteca e NJB me literaturë në gjuhën greke, e cila mbështet programin e studimit me bibliografi të pasur, nteresat e studenteve dhe të komunitetit më të gjerë.
6. **Ndërkombëtarizimi.** Veçoria e NJBGJLQGR krijon mundësi të mëdha , të vërtetuara në praktikë, për të realizar marrëveshje bashkëpunimi me institucione universitare , akademike dhe faktorë të tjerë ndërkombëtare, sidomos me ato greke. Marrëveshjet e bashkëpunimit me shumë universitete greke, hithja e projekteve dypaleshe dhe nga BE-ja, arritja e njohjës së diplomës së programeve të studimit të UGJ nga pala greke përbën një tregues për këtë pikë të fortë të NJBGJLQGR
7. **Cilësia e studenteve të rekrutuar. Programi i studimit** në proces akreditimi thith studentë të një cilësie të lartë. Nota mesatare e tyre është përgjithësisht mbi 8 dhe ky nivel cilësie ruhet në të gjithë ciklit të studimit.
8. **Marrëdhëniet staf akademik-studentë.** Përbën karakteristikë dalluese dhe pikë e fortë fakti i marrëdhënieve shumë të mira bashkëpunuese dhe motivuese midis stafit akademik dhe studenteve.
9. **Memoria dhe promovimi i NJBGJLQGR.** Krijimi i arkivave të formave të ndryshme për historikun, aktualitetin dhe veprimtarinë e NJB përbën një aset i fortë për të (Albume, dokumentare, estimi i përvjetorëve, faqe interneti dhe mjete të tjera komunikimi publik)

**Pika të dobta:**

1. **Numri i studenteve.** Ka një zvogëlim të numrit të studenteve për shkak të shkallës së lartë të emigrimit të komunitetit nga vijnë studentët e NJBGJLQGR.
2. **Nëvoja për ndryshime të programit të studimit dhe stafi akademik**. Programi i studimit ndryshon në korrespodencë të nëvojave të aktualitetit dhe të përspektivës. Këto ndryshime nuk mund të jenë përfekte për shkak se shpesh ato duhet t'i përgjigjen edhe stafit akademik I cili është i dhenë dhe me profilizime të përcaktuara.
3. **Azhornimi me bibliografinë koherrente.** Është realtive dhe lidhet më së shumti me faktorin e mësipërm.
4. **Lëndët e reja dhe ndryshimet në titullarët e lëndëve.** Përfshirja e lendëve të reja në programin e studimit kërkon edhe titullarët e tyre staf akademik. Në kushtet e NJBGJLQGR kjo përballohet me vështirësi dhe me nëvojën e kohës për përgatitje nga ana e tyre.
5. **Ngarkesa e tëpërt e stafit akademik.** Programi i studimit që t'i përgjigjet nëvojave dhe përspektivës ka një një gamë të gjerë lendësh dhe fushash. Nëvojat për mbulimin e tyre, për veçoritë e programit dhe në kushtet e mungësës së stafit të kualifikuar edhe si të ftuar apëo me kohë të pjesshme , ngarkon stafin aktual me shumë tituj lëndësh dhe ndonjëherë jashtë profilit apo specializimit.

**Rekomandime:**

1. …..
2. …
3. ….

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "….."**

**Strengths and affirmations:** (*Panajot Barka)*

**1. Quality of the academic staff.** The academic staff of the Basic Unit has a long experience of academic work and scientific research. Everyone has been professionally trained to successfully cope with specific problems of the Basic Unit and the study programs as well as to show an outstanding performance in terms of relations with students, the community and in relation with foreign academic and non-academic institutions.

**2. Continuous qualification of the academic staff.** This process is continuous and differs in several ways such as: a. In participation in academic and scientific activities. b. organization of scientific and cultural activities, c. various publications (articles, monographs, university texts, textbooks, other publications) d. Qualifications for titles and degrees (one for the title of professor, one for the title of associated professor and four for the PhD degree).

**3. High employment rate.** The Basic Unit of Greek Language, Literature and Civilization has the highest percentage in the University of Gjirokastra in terms of employment. The content of the study program/s, the stimulation of the student's interests for different employment profiles that the study programs enable and the close cooperation with employers, are the outcomes of work that guarantee this high rate of employment.

**4. Contribution to Gjirokastra University, pre-university education and community.** The Basic Unit of Greek Language, Literature and Civilization has an outstanding number of contributions in our university in terms of scientific research activities, relations with foreign



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

universities, especially Greek ones, scientific publications and in other fields. In terms of pre-university education in the Ethnic Greek Minority, this department closely follows all the related processes. This Basic Unit has taken over the qualification of teachers, as well as the preparation of teaching texts in the mother tongue (over 45 titles). In terms of contribution to the community in the Ethnic Greek Minority, it participates and leads different cultural and promotional research. The participation of the academic staff with speeches, references, letters etc., increases the quality of any such activity.

**5. Adequate infrastructure.** In addition to the appropriate infrastructure at the University of Gjirokastra level, the Basic Unit of Greek Language, Literature and Civilization possesses its own specified environments equipped with all the appropriate tools. The difference is made by the library of this Basic Unit with literature in the Greek language, which supports and provides a rich bibliography of the study program appealing both to the students and the wider community.

**6. Internationalization.** The uniqueness of the department of Greek Language, Literature and Civilization creates great opportunities, already practice proven, to reach cooperation agreements with other institutions of higher education, academic institutions and other international institutions or factors, especially Greek ones. The cooperation agreements with many Greek universities, the launch of bilateral projects from the EU, the achievement of diploma recognition of the study programs of the University of Gjirokastra by the Greek side, is an indicator of this advantage of the department of Greek Language, Literature and Civilization.

**7. Quality of recruited students**. The study program in the process of accreditation absorbs students of a high quality. Their average grade is generally above 8 and this level of quality is maintained throughout the study cycle.

**8. Relations between the academic staff and the students.** Other distinctive and strong advantages of our Unit are the cooperative and motivating relations between academic staff and students.

**9. Memory and promotion of the department of Greek Language, Literature and Civilization.**

The creation of various forms of archives for its history, current affairs and activity is a strong asset for this Basic Unit (Albums, documentaries, anniversary editions, websites and other means of public communication).

**Weaknesses:**

1. The number of students. There is a decrease in the number of female students due to the high rate of emigration of the community where the department of Greek Language, Literature and Civilization students come from.

2. The need for changes in the study program and academic staff. The study program changes in accordance with current and future needs. These changes cannot be perfect because they often have to respond to the academic staff to whom they are given and with their defined profiles.

3. Updated contemporary bibliography. It is mainly relative and mostly related to the above mentioned factor.



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

4. New subjects and changes in subject lecturers. The inclusion of new subjects in the study program also requires the academic lecturer of the subject. In the conditions of the department of Greek Language, Literature and Civilization, this is faced with difficulty and with the need for time for preparation on their part.

5. Overload of the academic staff. The study program, in order to respond to the market needs and perspectives has a wide range of subjects and fields. The need for the completion of all the points of the program and in conditions of the lack of qualified staff, even as guests or part-time member, the unit burdens the current staff with many subject titles and sometimes outside their profile or specialization.

Recommendations:

1-

2-

3-



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | po |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | po |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | po |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | po |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | po |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | po |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | po |



REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit**

Lista e mëposhtme është dokumentacioni i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë, por në një dokument mund të përmblidhen disa nga të dhënat e kërkuara. Në rastin e programeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë (Specializim Afatgjatë dhe Doktoratë) i gjithë ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqip dhe angleze ashtu si dhe RVB. Në cdo rast bazohuni në Manualin për "*Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit*"

1. Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë

Programin;

2. Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm;

3. Regullore e programit të studimit;

4. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit;

5. Strategjia e zhvillimit të programit;

6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare;

7. Politika të burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen;

8. Politika e zhvillimit të stafit akademik;

9. Struktura organizative e IAL dhe programeve;

10. Politika e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentëve;

11. Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie;

12. Politika të vlerësimit akademik të stafit e mësimdhënies;

13. Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit etj;

14. Diplomat dhe suplementet e diplomave;

15. Procedurë dhe ankimimi për studentët;

16. Procedurë për mbështetjen, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit;



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

EA

17. Procedura për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;

18. Politika e pranimit të studentëve;

19. Procedura e regjistrimit të studentëve, databaza e studentëve/regjistri;

20. Politika të mbështetjes, përkrahjes, u etj për studentët dhe struktura organizative të tyre;

21. Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet në nivel programi;

22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit;

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR